

# Kuvendi

## Qarku Fier

### **Arbjan Mazniku:**

Atëherë, vijojmë mbledhjen. Do marrim një vendim pak minuta më vonë përsa i përket, kur të kemi mundësi të bisedojmë edhe me bashkëkryetarin përsa i përket takimit të tretë që është Shkodra. Por do të vijojmë tani me pyetjet përsa i përket Qarkut të Fierit. Së pari, ju kërkoj ndjesë për tejkalimin e kohës dhe kohën që kemi pritur dhe juve dhe deputetëve të Qarkut që janë prezent. Dy-tri gjëra që janë procedurale, nuk do bëj parashtesë kështu mbi çështjen, por vetëm për gjëra procedurale. Çfarë kemi rënë dakord është që të kemi një seancë dëgjimore me kryetarët e bashkive, në të cilat deputetët drejtojnë pyetje në lidhje me tre kolonat që kemi strukturuar punën me kompetencat, çfarë funksionon, çfarë s'funksionon, pra gjëra që kanë të bëjnë me gjithë fushën e funksioneve dhe kompetencave që bashkitë kanë. Kolona e dytë ka të bëjë me financat vendore, qoftë kjo me të ardhurat e vetë bashkive, qoftë kjo me grantin, dhe kolona e tretë ka të bëjë me territorin. Dakordësia është që bëjmë pyetje nga një nga secili prej kaheve dhe më pas përgjigjet kryetari i cili është bërë pyetja, ose secili prej kryetarëve, nëse pyetja është për të gjithë, duhet të tentojmë për sa kohë që është e mundur t'i mbajmë pyetjet e përmbledhura, në mënyrë që t'i japim efektivitet kohës. Kërkesa tjetër që kam është që kur ka pyetje teknike për të cilat ju do keni nevojë që të keni një përgjigje teknike me numra apo shifra, të cilat mund të mos i keni sot me vete, ne do ja çojmë një pjesë të pyetjeve pas zbardhjes dhe në formë shkresore, që të na i sillni informacionin eventualisht përgjigjen në formë shkresore. Kështu që këto janë pak a shumë parimet. Tani mendoj që të kalojmë drejtpërdrejt te pyetjet. I pari, zoti Mziu ka pyetjen e parë.

### **Xhelal Mziu:**

Faleminderit, kryetar. Së pari, nuk më duket normale që kryetari i bashkisë Qendër-Qarku nuk është i pranishëm dhe nuk është e para herë, pothuajse të gjitha qarqet, në 70% prej tyre, nuk ka qenë drejtuesi i bashkisë Qendër-Qarku dhe kjo nuk është normale aq më tepër kur thritet në një komision të posaçëm që është fiks për këtë punë dhe nuk e di, domethënë, është strategji e PS-së apo është baraktarizëm i drejtuesve të bashkive Qendër-Qarku. Dhe shkon po prapë në rezonancë që kur ke kompetenca më shumë sesa duhet në aspektin me një bashki të dytë, pra kur të duket qendra e Qarkut sikur udhëheq botën, e bën pastaj të pandjeshëm edhe ndaj komisionit, por edhe ndaj vetë forcës politike, siç jeni dhe ju. Për të shkuar, për të qenë konkret me çështjen dhe për të qenë oportun me atë se çfarë kërkohet, doja të ngre disa problematika të cilat i hasim në kontakt me qytetarët për shkak të reformës territoriale dhe do të dëshiroja që pyetjet dhe shqetësimet që unë kam të kisha një prononcim tuajin dhe në marrëdhënie me bashkinë tuaj dhe konceptin që ju keni për më tej. Mbaj mend që përpara 2014-s, taksa biznesi i vogël menaxhohej nga kryetarët e bashkive, zoti o Zara! Pra, çfarë do të thotë që taksa biznesi i vogël mblidhej nga bashkitë dhe përfitonte bashkia? Normalisht, një forcë politike mund të ndërmarrë dhe iniciativën për t'i falur taksën e biznesit të vogël, por nuk e ka të

drejtën që të ardhurat e pushtetit vendor për biznesin e vogël t'i amnistojë ose t'i falë qeveria dhe ndërkohë të mos marrë iniciativën për t'i kompensuar. Dhe pyetja ime është: jeni më mirë kur e mblihdhni më përpara taksën e biznesit të vogël apo sot që nuk e mblihdhni dhe ndërkohë as nuk ua transferon shumën që ju takonte siç ishte më përpara dhe as nuk u jep, po themi, kompensimin e kësaj të ardhure të munguar? Dhe pyetja ime është: ndiheni më mirë duke e marrë taksën e biznesit të vogël apo duke mos e marrë? Pyetja e dytë: janë në të gjitha vendet e rajonit aplikohen, po themi, një përqindje e caktuar përse i përket taksave kombëtare, sidomos tatimit mbi të ardhurat, rentën minerare dhe të tjera të cilat i akordohen pushtetit vendor në një përqindje të caktuar? Kemi një numër të konsiderueshëm prej tyre që nuk jepen, por dhe ajo që jepet është simbolike. Unë nuk kam ndonjë shifër konkrete, bie fjala. Për mallakasjen e këtyre që mund të kenë dhe nga renta minerare apo të tjera që mund të përfitojnë, por qoftë edhe të gjitha bashkitë. Por është një përqindje shumë e vogël e nëse ne e krahasojmë me vendet e rajonit dhe me Bashkimin Evropian, marrim shumë pak. Bie fjala, kjo është një ardhurë që duhet t'ju kalojë kombëtare, kjo është një rentë që duhet t'ju vijë, por duke parë informalitetin, përqindjen shumë të lartë, përfitueshmëria e saj është me 0.000, çfarë do të thotë që është absolutisht e pandjeshme. Dhe pyetja ime është: a do të ishit dakord që bashkia që ju drejtoni të përfitoni, si vendet e tjera të rajonit dhe Bashkimin Evropian, në lidhje me rentën dhe me taksat kombëtare, sidomos në lidhje me të ardhurat? Një tjetër shqetësim kisha me delegimin e kompetencave. Janë deleguar kompetenca, sa më shumë kompetenca të delegohen, aq më mirë është, sepse nëse ka një strukturë shtetërore që lidh marrëdhënien e shërbimeve dhe të investimeve, është pushteti vendor. Mirëpo, e kemi hasur gjatë gjithë këtyre 12 viteve, 11 vite, se akoma s'janë bërë 12, që janë deleguar kompetenca dhe nuk janë shoqëruar, po themi, me mbështetje financiare. Dhe besoj që dhe ju e keni vuajtur këtë çështje. Bie fjala, vjen zjarri dhe çfarë mund të bëjë kryetari i bashkisë për të shuar zjarrin kur nuk ka mjaftueshme, po themi, mjete apo të punësuar dhe paratë nuk mjaftojnë për këtë drejtim? Dhe për pasojë, detyrohet bashkia për të përdorur nga ai hambari i vogël i bashkisë për t'i tjetërsuar përse i përket zjarrfikësve. E njëjta gjë ndodh tek vadijtja. Ia kanë kaluar këtë barrë vadijtjes që luan një rol jo pak të vogël në lidhje me bujqësinë, por është e pamjaftueshme. Vlera e të cilës është kaluar. E njëjta gjë edhe me Bordin e Kullimit. Dhe ndodhin madje dhe përmbytje dhe bashkia detyrohet, po prapë, për të përdorur asetet e veta që mund t'i dërgonte diku tjetër për të mbyllur këtë boshllëk. E njëjta gjë ndodh, po themi, edhe me pyjet. Ka bashki të cilat kanë pafundësisht pyje dhe e kanë të pamundur për ta luajtur rolin, ndërkohë të ardhurat janë simbolike ose delegimi i tyre. Për të mos u zgjatur në këtë drejtim ndonjëherë, a ju mjaftojnë ato kompetenca me fondet që janë? A keni përdorur ju fondet e bashkisë ose duhet të keni përdorur fondet e bashkisë ose duhet ta keni lënë pa e zavaruar atë shërbim ndaj qytetarëve? Ndërkohë, po të shohësh, ne sot marrim, bashkitë marrin vetëm 1% transfer të pakurzuar në fillim të vitit dhe s'morën asgjë tjetër përveçse këtyre delegimit të kompetencave dhe të arsimit, pra universitar përse i përket mirëmbajtjes, etj., që janë të pamjaftueshme dhe mirëmbajtja e qendrave shëndetësore edhe e shkollave, etj., etj. Pra, nëse shkojmë tek vendet e rajonit dhe përtej rajonit, shkon diku tek 6-7% të GDP-së. Nëse ne i referohemi shifrave që kemi, nuk shkojmë as te 3% nëse i morin dhe këto kompetenca të cilat nuk janë kompetencë, janë thjesht një kostoshtesë për pushtetin vendor. Tjetër gjë

është, ka të bëjë, po themi, me taksën ose më saktë me atë 1% e PBB-së ose më saktë transferen e pakuruar në fillim të vitit. Ka qenë 1% ku më përpara merrnim atë taksën e biznesit të vogël etj., por sot ne edhe e tungojmë. Ka bashki, bie fjala, Fieri, jam i sigurt që s'ka nevojë për të ardhur se ka mjaftueshëm të ardhura, biznese pa fund, por nuk e ka këtë luks bashkitë tuaja të cilat janë periferike. Dhe mesatarja e të ardhurave të veta që krijon një bashki në periferi, krahasuar me qendrën e qytetit ose të qytetit Qendër-Qarku, janë shumë herë më pak. A keni marrë fond balancimi si bashki të cilët nuk keni, nuk keni, po themi, një barazi të të ardhurave përfrymë nga të ardhurat e bashkisë? Sepse vendet e rajonit dhe vendet e Bashkimit Evropian, minimalisht 1-2% të GDP-së kalohet për kompensimin e kësaj. Pra, bashkitë të cilat kanë të ardhura përfrymë më pak sesa 50% e të ardhurave, kompensohen nga buxheti i shtetit dhe në dijeninë time nuk është bërë ky kompensim, por ne po shkojmë drejt Bashkimit Evropian. Përse nuk aplikojmë një fond të tillë balancimi që qytetarët të jenë, po themi, të barabartë, mos e braktisin bujqësinë, mos e braktisin arsimin, të mos ikin në Eksod sepse nuk plotësohen kushtet e nevojshme? Një tjetër shqetësim është dublimi i kompetencave, dublim kompetencash. A ndiheni rehat ju në bashkitë tuaja kur ka një ndërtim pa leje dhe vjen policia e shtetit, vjen IKM-toja e nëse bëni ndonjë ndërtim të lartë, vjen dhe e azhëtojnë? Përse ligji të mos jetë specifik? IMT-ja është për pushtetin vendor, nëse ka ndonjë gjë makro, mund të vijë struktura të tjera, policia është e përcaktuar për t'u marrë me rendin e të tjerave. Nuk ndodh në vendet e tjera. Pra, do të kërkoja të ndiheni rehat me dublim kompetencash, sepse kush e pëson? Në fund të fundit, e pëson qytetari se atij i shkon polici në mjeshtë, IMT-ja në drekë, pas dreke IKM-toja, tre gjopa për të mbyllur çështjen kur ligji e ka paracaktuar, e ka parashikuar qartë që duhet të jetë bashkia ajo e cila duhet të merret me këtë çështje dhe nëse IMT-ja apo bashkia shkel ligjin, personat shkojnë dhe e vuajnë atë problem që i shkaktohet. Një tjetër marrje kompetence, megjithëse kemi kryetarin e bashkisë qendër, por besoj që ju nuk e keni edhe fatin për të patur pallate mbi 5 kate, por edhe ajo është një tjetër marrje kompetence, po themi, që lejet me kate të mëdha duhet të vijë tek kryeministri dhe të tjerat jo. Përse i përket një tjetër sfidë, 2015-ta, mbaj mend që u bë reforma që do t'i kurseshin buxhetit të shtetit jo pak, por diku te 80 milion euro dhe që do të ulej struktura për shkak të ekonomisë së shkallës. Në fakt, ka ndodhur e kundërta, është dyfishuar numri i administratës. Secila prej bashkive tuaja ka rritur fondin e pagave, jo vetëm për shkak të nivelit të pagës, por edhe për shkak të rritjes së numrit të punësuarve. Dy, do të jenë tre herë më shumë sesa në vitin 2015 dhe jam absolutisht i bindur që një numër jo i pakët i administratës më shumë luajnë rolin e patronazhistit sesa luajnë rolin e funksionit, sepse është e pamundur, po themi, që me ekonominë e shkallës të rritet numri i administratës. Një pyetje tjetër ka të bëjë me përfaqësimin e komunave që kishin më përpara, kishin një këshillë, kishin dhe përfitime të drejtpërdrejta që i shkonin nga buxheti i shtetit. Sot, një kryetar bashkie dhe unë po të isha kryetar i një bashkie, do të merresha më shumë me qendrën e qytetit sesa me komunat në periferi. A hasni në problematikën e mos-përfaqësimit të këtyre ish-komunave që s'kanë këshillë? A trajtohen me dashje apo pa dashje si të njerëz në periferi? Sepse e kanë të pamundur, secili prej jush do të mbante më shumë qytetin, zonën urbane sesa pjesën e saj të largët. Unë nuk po zgjatem më tej, do të dëshiroja edhe për shkak të ekonomisë për të më kthyer një përgjigje për ato shqetësime që unë thashë.

## **Arbjan Mazniku:**

Për procedurë, ju lutem, para se të hajmë në mikrofon.

**F**aleminderit, zoti bashkëkryetar dhe ju, zoti bashkëkryetar i opozitës. Megjithëse do të doja ta kisha marrë fjalën që në fillim, duke parë që jemi të ftuar si deputetë dhe jo si anëtarë të komisionit të posaçëm, por një këshillë miqësore do t'ia jepja juve që t'u jepni më shumë prioritet deputetëve të qarqeve kur janë edhe në rolin e të ftuarve, pavarësisht se s'janë anëtarë të komisionit të posaçëm, se ky komisioni, vetë fjala "i posaçëm" është i përkohshëm, nuk vazhdon gjithmonë. Dhe së dyti, do të doja të dija nga bashkëdrejtuesit: Ardhja e kryetarëve të bashkisë në një dëgjese është e detyrueshme apo është në dëshirën e kryetarëve të bashkisë? Në rastin se të gjithë kryetarët e bashkive do të kishin ndonjë punë të arsyeshme sot dhe nuk do të kishin ardhur, do ta zhvillonin dëgjесën? Mungesa e kryetarit të bashkisë me qendër-qarkut të Fierit, zotit Subashi, është bashkia më e madhe e qarkut të Fierit dhe mungesa e tij në këtë dëgjese nuk është aspak serioze. Çfarëdo lloj justifikimi që mund të më thoni, mbledhje këshilli bashkiak që s'para e ka shumë problem se i komandon me telefon nga larg, prania e tij do të ishte këtu e domosdoshme, mendoj unë, dhe në respekt të këtij komisioni të nderuar dhe të këtij procesi shumë të rëndësishëm që është i dakordësuar me mazhorancën dhe opozitën. Parë në këtë këndvështrim, unë mendoj se kjo seancë, kjo dëgjese nuk duhet të ishte filluar. Për të qenë më serioz, duhet të ishte shtyrë koha, anuluar për arsye se nuk ndodhi gjë që ne e kishim në orën 12:00 dhe jemi në orën 15:00. Për të filluar 3 orë me vonesë dhe kjo jo për fajin e kryetarëve të bashkive të qarkut, se kanë ardhur dhe presin me orë të tëra dhe derisa nuk ishte dhe ekipi i plotë, ashtu siç ishte ekipi i qarkut të Beratit pak më parë, mirë do të ishte që kjo dëgjese të mos zhvillohej. Për mua është një dëgjese gjysmake, formale, por si duket është ajo që unë e kam thënë shpesh herë, mua më duket që edhe ky komision me këtë reformë, pavarësisht punës vërtet serioze që bën dhe për këtë unë kam vlerësim, mendoj se rezultati duhet të jetë poshtë tavolinës i ruajtur nga kryeministri juaj për ta nxjerrë mbi tavolinë në momentin e duhur dhe reforma të jetë, domethënë, një xhiro bosh. Gjithsesi, po përqendrohem vetëm te seanca e sotme. Në qoftë se nuk do të ketë një anulim të kësaj seance, unë mendoj personalisht, por unë jam një deputet i parlamentit që kam ardhur me një ftesë, meqëse jam deputet i qarkut të Fierit dhe do të largohem në qoftë se kjo seancë nuk do të anulohet, për të qenë kryetar i bashkisë së qarkut të Fierit këtu. Faleminderit!

## **Arbjan Mazniku:**

Atëherë, faleminderit për ndërhyrjen tuaj. Ne e kemi bërë të qartë dhe kemi qenë dakord, në fakt, të dy bashkëkryetarët, po ju them, që mos-prezenca e kryetarëve të bashkive është problematike dhe kemi rënë dakord paraprakisht që në fund do të lëmë një kohë dhe një kërkesë për kryetarët e bashkive që nuk kanë pasur mundësi të vijmë për arsye të caktuara që të jenë prezentë. Nga ana tjetër, është e rëndësishme të theksojmë një gjë: kjo është një dëgjese që do të thotë është një mundësi për kryetarët e bashkive të vijmë dhe të shprehen. Këtu ne kemi sot 5 kryetarë bashkish të nderuar nga bashki shumë të rëndësishme të cilët kanë opinionin e tyre. Do të dëgjojmë opinionin e këtyre për bashkinë

e vetë. Kryetari i bashkisë që nuk ka ardhur sot do të ftohet një datë tjetër, meqëse mund të arsyetohet që mund të ketë probleme axhende në një moment të caktuar. Nëse nuk do të vijë, është i kanë mohuar vetes mundësinë për t'u shprehur përpara komisionit dhe kjo nuk është një. Pra, ne i kemi bërë institucionet autonome për shumëçka, sa më pak për të folur, kështu që ky është vendim autonom i tyre dhe e gjykojnë vetë kryetarët e bashkive. Ne do t'u japim oportunitetin, duke qenë se dhe organizimi i axhendës është kompleks dhe është normale që dikush të ketë një udhëtim, dikush të ketë një gjë që nuk lëviz dot, të mos jetë prezent, do t'u japim një datë tjetër. Nëse nuk vijë, kanë djegur mundësinë që të dëgjohen, kështu që unë besoj që nuk ka asnjë arsye pse mbledhja të mos vijojë dhe të dëgjojmë ata kryetarë që kemi. Kështu që unë do të kisha dashur dhe me dakordësinë dhe me të zotit Boçi që pyetjet që bëri zoti Mziu të fillojnë të marrin përgjigje nga kryetarët. Për të kaluar, t'ua kaloj fjalën kryetarëve për t'i dhënë përgjigje pyetjeve që bëri zoti Mziu, ndoshta me radhë, sipas dëshirës. Nëse ju kërkuat fjalën, filloni ju.

### **Eriselda Sefa:**

Përshëndetje! Përshëndetje, shumë faleminderit që na bëtë të mundur që të jemi pjesë e kësaj dëgjese, ku patjetër të shprehim dhe opinionin tonë se çfarë ka pasur pozitive apo negative kjo reformë në gjithë këto vite. Fillimisht do të doja të prezantoja pak veten, duke qenë para reformës administrativo-territoriale, një punonjëse e administratës së bashkisë së qytetit. Për rreth katër vite kam drejtuar këshillin e një komune që sot është bërë pjesë e bashkisë Lushnje dhe sot drejtoj një bashki të madhe që është bashkia e Lushnjes, e cila përbëhet nga qyteti i Lushnjës dhe nga 10 njësitë administrative rurale, të cilat më parë kanë qenë në rolin e ish-komunave. Nëse do të merrja opinionin tim personal, mendoj që kjo reformë patjetër që i ka shërbyer më shumë qytetarëve tanë, sepse qëllimi kryesor i bashkive, duke qenë se janë institucioni i cili i shërben drejtpërdrejtë qytetarëve dhe kanë lidhje drejtpërdrejtë me qytetarët, është që të jenë sa më funksionale, por patjetër të shkojnë edhe në një shërbim sa më cilësor për qytetarët tanë, si për ata qytetarë që jetojnë në qendër të bashkisë, por patjetër dhe ata që jetojnë në fshatin më të largët, të cilin në territorin e bashkisë Lushnje nuk është se janë shumë të largët, kur fshati më i largët arrin deri në 35 km. Gjatë këtij dhjetëvjeçari që ka funksionuar, bashkia e madhe ka bërë që të jetë një bashki më e fortë ekonomisht, çka ka sjellë që të sjellë më shumë shërbime, por patjetër edhe më shumë investime për qytetarët e saj. Nëse kur unë e kam drejtuar këshillin e komunës së asaj njësie që dikur quhej. Patjetër të jap opinion. Po ja pra, t'ju kthej përgjigjen. Po pra, po ma lër pra të kthej përgjigjen, kthe më opinionin, mos zotëri. Patjetër, tani duhet patjetër që ta them që ka funksionuar apo ka dështuar. Më duhet të jap shembullin dhe modelet që do të thotë kur kam drejtuar këshillin e një komune, përveç pagave që ajo komunë arrinte të mundësonte atyre punonjësve, ku në shumicën e rasteve mbesnin me muaj të tërë të papaguara, sepse e vetmja mundësi për ta ishte vetëm granti që merrnin nga qeveria, sot nuk ka ndodhur në këto 11 vite të kësaj bashkie që punonjësit e bashkisë Lushnje të kenë mbetur qoftë dhe një muaj të vetëm pa paga, por patjetër që të marrin dhe shërbimin dhe investimin në të gjithë territorin e saj. Sot, kur ne miratojmë buxhetin, parashikojmë që të prekim me investime çdo njësi administrative, qoftë urbane, qoftë rurale. Kjo edhe për faktin sepse ne në këshillat tonë bashkiak kemi anëtarë dhe

përfaqësues nga çdo njësi administrative. Të paktën, Partia Socialiste në anëtarët e kësaj të këshillave bashkiak në këto 11 vite ka vënë përfaqësues nga çdo njësi administrative, në mënyrë që qytetarët e saj të ndihen të përfaqësuar dhe të kenë një zë për të kërkuar shërbime dhe investime në shërbim të tyre. Që duhet akoma më shumë të kemi mbështetje financiare, si në rastin e taksave të biznesit të vogël apo nivelin e taksave kombëtare, patjetër, sepse shpeshherë në shumë funksione, të cilën e kemi diskutuar edhe në shumë mbledhje të tjera që jemi mbledhur si kryetarë bashkie, si me shoqatën, por patjetër dhe ministrat përkatëse, është që shpeshherë na delegohen funksione pa financa dhe patjetër që pa pasur financa është shumë e vështirë për ne që t'i shërbejmë qytetarëve tanë ashtu si duhet dhe ashtu siç ata e meritojnë. Ajo që ne mendoj, unë personalisht mendoj, është që bashkitë duhet të jenë më shumë autonome si nga ana e funksioneve, por patjetër edhe nga ana financiare, sepse ashtu mendoj që shërbimi ndaj qytetarëve të saj do të jetë akoma më i mirë. Faleminderit!

### **Josif Gorrea:**

Mirëdita! Faleminderit që na keni bërë pjesë. Do mundohem shkurt t'ju përgjigjem një pas një pyetjeve që ngritët, të nderuar. Së pari, dua t'ju thosha që Bashkia e Dhivjakut është një qytezë e vogël. Në regjistrin e Gjendjes Civile jemi me 50 mijë banorë dhe së fundmi kemi përfunduar në 27-28 mijë banorë. Do të thosha që është një bashki rurale, 17 mijë hektarë tokë bujqësore, 3 mijë hektarë kodra. Është bashkia më e lidhur me tokën, ku bujqit çdo ditë e punojnë atë, më e lidhur me detin, me lagunën, me pyllin. Është një bashkëjetesë e jashtëzakonshme, e cila duhet të përmirësohet. Gjithashtu, doja t'ju tregoja që kjo treg vjen nga historia shumë të largët, në shekullin e gjashtë para erës sonë. Aty ka qenë një qytezë që quhet Arnisa. I duhet? Po, i duhet. Patjetër do të respektoj kohën, duke respektuar kohën, duke respektuar kohën. Në atë qytezë që thashë që quhet Arnisa, e caktuar nga një gjeograf i madh romak shekulli i dytë të erës sonë, është gjendur një statujë e vogël, ku sot është një nga mrekullitë e asaj kohe. Është vepra artistike më e bukur e botës se asyre kohërave. Në lidhje me momentin ku jemi, gjithashtu do ja thosha që kjo qytezë përmendet për herë të parë në 1440-ën, ku Dhivjaku del si fshat me 20 shtëpi dhe 200 banorë. Në lidhje me pyetjen tuaj, taksat e biznesit të vogël, kjo është një vendim politik, do ta quaja unë, ku nuk i përket pushtetit vendor, por është një veprim më lartë, pra i përket forcës politike që ka fituar mandatin për të vepruar, për të diktuar reformat dhe mënyrën e vjedhjes së taksave. A është kjo problemi? Unë këtu nuk e shikoj tek biznesi i vogël. Unë problemin e shikoj: a e ka marrë bashkia atë ndihmëz, ndihmëzën e duhur nga totali i GDP-së që ka Shqipëria? A duhet të ishte më e mbështetur pushteti vendor në lidhje me ato kompetenca që i kanë kaluar? Patjetër mendoj që duhet të kishte shumë më tepër mbështetje financiare. Renda minerale, në rastin tim, unë nuk e kam këtë, por kam diçka tjetër. Jam zona më bujqësore në Shqipëri, ku po marr një element që ne jemi të lidhur me tokën dhe është shumë e rëndësishme që bujqësia që ne prodhojmë dhe që eksportojmë nuk na kthehet mbrapsht në një farë mënyre. Si do ta quaja këtë? Po të marr një element, po marr vetëm salqinin. Në eksportojmë si Dhivjak 4 mijë, 5 mijë tonë salqi. Po ta shumëzonim këtë me 1 çmim mesatar 20 lekë, pra ka një shifër. Pra, ndikon direkt në balancin tregtar të shtetit shqiptar. Pra, mora vetëm një kulturë. Po t'i marr kulturat e tjera, pra e kthyer te renda minerale, do të thosha, ky është

një element tjetër që nuk është parë ndonjëherë, që mendoj që duhet të shikohet nga komisioni, pra për mbështetjen në një formë tjetër. Në lidhje me elementet e tjerë, ju thashë zjarri apo emergjenca civile. Po, është e vërtetë që na kanë kaluar këto kompetenca. Nuk është vetëm zjarrfikësit. Na kanë kaluar gjithashtu edhe arsimit parauniversitar. Të gjitha këto elemente duhet të ishin mbështetur pak më mirë financiarisht, patjetër, dhe ndaj mendimi që shumë më mirë duhet të ishin mbështetur këto elemente. Gjithashtu edhe juve përmendët gjithashtu ujin ose ujitjen. Edhe ky element, megjithëse jemi munduar ta menaxhojmë në mënyrën më të mirë të mundshme, ka nevojë për përmirësim. Këtu do të ndalesha. Këtu do të ndalesha në një element tjetër të rëndësishëm. Mendoj që në këtë moment, të paktën bashkia ime, e shikoj si një ndërmarrje komunale në lidhje me arsimin, shëndetësinë, bujqësinë, ku shpeshherë na detyrohemi që të na marrin telefon drejtoresha e shkollës që na është shtyrë xhami ose më është prishur dritarja. Ndërkohë, mendoj që reforma tek arsimi, tek shëndetësia, do të kishte më shumë kompetenca pushteti vendor. Mendoj që që drejtori i arsimit duhet të ishte pjesë e bashkisë. Mendoj që në këtë moment ku jemi, kur pak njerëz na kanë ngelur nëpër territore, mendoj që duhet të rishikohet edhe emërimi i mësuesve. Patjetër duhet të shikohet CV-ja, patjetër nuk duhet të dalim nga kurrikula, por mendoj që autoriteti i pushtetit vendor duhet të jetë pak më i lartë. Po marr një rast të rëndomtë: një mësues është emëruar nga Lushnja, mos ma merrni për keq, ose diku tjetër, por a nuk do ishte më mirë që të kishte nja 5 pikë më pak një mësues që të ishte nga një fshat që ka më në afër, nga Shën E premtja, për shembull, sepse këtë mësues. Një element tash, po mirë pra, por nuk është sepse do të shikohet sot, sot, ju lutem. Unë po flas për rastet kur është, por nuk po flas hipotezë, nuk është. Po flas kur është e mundur. Dakord, pra në rastin kur është e mundur, absolutisht mendoj që duhet të shikohej ajo, të mund të tejkalohet pak ajo radhë dhe të ishte një mësues më afër, sepse në rastin e mësuesit nga Lushnja, neve paguajmë edhe transportin për të dhe njëra e para. E dyta, nuk e kam në orar se ai do të shikojë orën se ikën autobuzi, nuk mund ta përdorë pasdite. Kur më duhet, e njëjta gjë do të ishte në shërbimin. Gjithashtu, duhet të shikohet edhe transporti i nxënësve. Mendoj që transporti i nxënësve sot, që është kompetencë e ministrisë, do të ishte më mirë që ta menaxhonte bashkia, jo thjesht që të gjente autobuzat, por mendoj që do të ishte më mirë dhe do ta menaxhonte më mirë ta bashkëpunonte, ta bashkërendiste këtë me qarkullimin tjetër ku ishim. Problemi më i madh tek financat, shikoj unë si një bashki e vogël që jam, po a e mesme nuk e di. Është sepse për fatin tim të keq, ne ngelemi në një bujqësi dhe turizmi në vendin tim është pak i zhvilluar. Pra, nëse do ta krahasoja veten time ose bashkinë me një bashki tjetër, Kavajë apo Himarë, dihet që të ardhurat e tyre vetëm nga turizmi janë shumë më të larta, ndërsa tek ne kjo është më e pakët. Kështu që këtu, një pengesë tjetër, mendoj unë, pengesë tjetër që na e pengon rritjen e të ardhurave nga gatimet është edhe prona. Prona është një problem i përgjithshëm që duhet të shikohet. Transferta nga grantet, patjetër mendoj që do të ishte më mirë, e krahasuar dhe me vendet përreth që u përmend. Në lidhje me moshat e treta ose familjet në nevojë, se këtu unë shikoj një plan më të gjerë se ku mund të bashkëpunojmë me bashki të tjera. Mendoj që mund të shikojnë të paktën territorin tim. Moshë e tretë është në rritje. Kjo nuk është vetëm ky problem. Problemi tjetër është që ajo tradita shqiptare, kur babai, kur fëmija mban babain dhe babai mban gjyshin, tashmë është prishur. Po shikojmë që fëmijët kanë ikur

jashtë dhe i kanë lënë në pikë të hallet prindërit gjithandej, dhe kjo është masë që është në rritje. Unë çdo vit shikoj që kjo më është rritur në bashkinë time. Pra, kjo do të ishte një bashkëpunim i mirë, mendoj unë, rajonal. Që ne të bashkëpunonim në mënyrë për disa shtëpia, për disa për trajtime më të mira ndaj moshës së tretë. Ta lë këtu. Patjetër, patjetër mendoj që reforma ka bërë shumë të mira përpara. Ka përmirësuar shumë gjëra. A duhet thelluar? Po. Mirë, tani. Faleminderit.

**Luçiano Boçi:**

Po, zonja Bufja ose Ismailaj. Po.

**Qerim Ismailaj:**

Përshëndetje, shumë faleminderit që jemi pjesë e kësaj djeshe. Mbështetur në përvojën time 26-vjeçare, që mund të them me një fjalë të thjeshtë që reforma administrative territoriale e 2014 dhe aplikuar në 2015-n nuk mendoj që është një sukses i plotë. Natyrisht që ajo çfarë ka të bëjë është thënë. Reforma ka si synim vetëm rritjen e shërbimeve ndaj qytetarëve. Unë e kam një përvojë. Kam qenë kryetar komune, sekretar i këshillit të qarkut dhe praktikisht tani aktualisht jam kryetar i bashkisë Malakazër. Dhe besoj që kam një njohje personale shumë të gjerë në fushën e pushtetit lokal. Natyrisht, këtu nga zoti Mziu bën disa pyetje dhe pyetjet të cilat lidhen me anën ekonomike, besoj që nuk ka asnjë person, as shoqatë, as institucion që të kënaqet me financime. Natyrisht, sa më shumë është gjithmonë e më mirë. Por në rast se ne do të bëjmë krahasimin se si kanë qenë të ardhurat ose edhe niveli i taksimit në ish-komunat ose ish-bashkitë.

**Luçiano Boçi:**

Pat një ndërhyrje zoti Ismailaj. Ismailaj, ndoshta në takimin e parë unë e thashë edhe këtu nuk pata mundësinë. Nuk jemi këtu për të bërë krahasimin e 2014-15-s me 2005-ën. Këtu jemi për të bërë ballafaqimin e reformës së 2014-s në raport me qëllimet, pritshmëritë që ajo përcaktoi. Kjo është në qoftë se ne dalim pastaj duam të lavdërojmë sa keq ishte kur ishim 373 dhe sa mirë. Kjo nuk na vlen si komision fare, se ne jemi këtu për të marrë ato masa, të themi ato për të bërë ato ndërhyrje ligjore që ju ndihmojnë juve në punën tuaj. Çfarë ju pengon punën tuaj? Kaq më shumë e thjeshtë.

**Qerim Ismailaj:**

Një sekondë, një sekondë, ju lutem, ju lutem, zoti bashkëkryetar i komisionit, besoj jam shumë i qartë përgjigjen që i dhashë, pasi dhe pyetjet të cilat u bënë zoti Mziu u bënë lidhur me konkretisht duke bërë krahasimin e periudhës, sepse taksa e biznesit të vogël ka qenë atë kohë. Sot, taksa e biznesit të vogël është zero dhe natyrisht që t'i referohem këtij këtej përgjigje kësaj pyetjeje, jam i detyruar që të bëj krahasimin e periudhës, sepse s'mund të flasësh për taksës, po jo të periudhës. Periudhave se e kuptoj unë, e kuptoj shumë mirë këtë pyetje. Ju jeni bashkëkryetari, por që të krahasosh diçka ose të thuash cila është pritshmëria, duhet të dish nga ku nisesh dhe kush dhe çfarë pret të arrish. Dhe unë po të bëj një shpjegim shumë të thjeshtë fare. Po e përmbledh gjithë këtë pyetjen e anës financiare. Thashë taksa e biznesit të vogël vërtet është zero, por mos harrojmë që

kjo kompensohet nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar e dhënë nga qeverisja qendrore dhe natyrisht unë kam gjithë tabelën. Ju lutem. Të lutem, ju lutem. Nuk është 1%. Të lutem, nuk është 3%. Jo, nuk abuzoj. Unë kam shifrat. Të lutem, 5%. Të lutem, unë kam. Okej, jo, nuk. Besoj, besoj, besoj që duhet të përdorim shprehjet. Nuk bëhem qesharak dhe nuk kam arsye që askush të bëhet qesharak. Po, të lutem, kam qenë edhe në atë kohë në pushtet lokal dhe po ta shpjegoj. E di shumë mirë dhe ju keni një përvojë të tillë. Kemi qenë kolegë dikur bashkë. E di shumë mirë se sa ka qenë niveli i taksave atëherë dhe e di shumë mirë sa është niveli i taksave sot. Ajo çfarë unë po përpiqem të them, po i përgjigjem pyetjes tuaj në radhë të parë. Sa ndikon taksa e biznesit të vogël dhe heqja e taksave të biznesit të vogël te buxheti i bashkive? Sepse në fund të fundit që të kesh shërbime duhet të kesh të ardhura dhe në qoftë se ne i referohemi edhe shifrave, marr bashkinë Malakazë me njësi të administrative që ka pasur dhe ka pasur goxha njësi administrative. Ka pasur bashkinë Ballë, që ishte qendra e Malakazës. Ka pasur edhe 8 njësi administrative të tjera. Ka pasur njësi administrative edhe me 1500 banorë, e cila ishte në jo eficient plot shërbime ndaj qytetarëve. Dhe natyrisht do ta shpjegoj edhe këtë pjesë se sa eficiente është sot bashkia si organizëm i tillë edhe në shërbim të zonave periferike rurale. E kam pyetjen tuaj, ju lutem, do i përgjigjem. E kam edhe këtë pyetje. Ju e ke bërë sepse asnjë problematikë ka lidhur me investime në zonat rurale me zonën qendër. Ma keni bërë dhe është pyetja e fundit. Ju lutem, do ta kthej përgjigjen. Lidhur me pyetjen tjetër, taksat, taksat kombëtare që është 1% i 1% i prodhimit bruto. Prodhimit të brendshëm, atëherë më duhet të them ne kemi një organizëm që është shoqatë e bashkive dhe gjithë këto problematika janë trajtuar në të gjithë diskutimet që kemi pasur si shoqatë e bashkive me përfaqësues të të gjithë kryetarët e bashkive. Sot ajo funksionon me 2 bashkëkryetarë, 2 forca politike. Janë problematika që çdo fillim viti ose çdo miratim viti buxhetor që bëhet në periudhën nëntor, shoqata e bashkive zhvillon takimet e veta dhe në bazë të atyre paraqet rekomandimet qeverisë. Një nga ato rekomandime në Komisionin e Ekonomisë e kam paraqitur edhe unë, që lidhet me rendin minerar, që ka qenë një propozim i yni, por patjetër që mirë do të ishte që të rishikohet dhe do mundohem ta shpjegoj pse duhet të riparë taksa e rendit minerar. Është një aset, i cili është një shembull konkret që unë besoj që duhet të përmirësohet, të ndryshojë në favor të bashkive. Të lutem, patjetër ajo që është fare e drejtë është e drejtë, por e drejtë është edhe kjo tjetër, sepse s'mund të mohojmë mënyrën dhe sensin e organizimit të punës në bashkitë e sotme dhe kjo në funksion të shërbimit ndaj qytetarëve. Kompetencat e deleguara ishte pyetja e tretë e juaja. Sa kanë mbi vendosje me njëra-tjetrën? Natyrisht, pushteti lokal ka një fushë të gjerë veprimtarie. Dhe një pjesë e tyre janë ose deleguara, ose transferuara përtej kompetencave të veta dhe natyrisht mes fondeve. Funksioneve janë shoqëruar dhe me fondet e deleguara përkatëse, siç është ai për emergjencat civile, zjarrfikësit dhe mbrojtjet civile, ku aktualisht nga qeverisja qendrore bashkitë përfitojnë fonde të destinuara vetëm për emergjencat civile. Bashkia Malakazë ka qenë një nga këto bashki të cilat ka përfituar dhe për kujtesë. Bashkia Malakazë është një institucion i cili është drejtuar nga dyja forcat politike, me përfaqësues edhe të PD-së edhe të PS-së. Dhe ajo çfarë është konkluzion e përmbledhur është që kjo reformë territoriale besoj që ka qenë një nga reformat më cilësore të bëra në funksion të shërbimit ndaj qytetarëve. Dublimi i kompetencave është e njëjta gjë që mbase këtu është një pikë që ka nevojë për

një qartësim dhe një përmirësim të kuadrit ligjor dhe ajo që lidhet me IMT-në, pavarësisht sepse policia nuk ka të drejtë e gjobës, por ka të drejtë e konstatimit dhe të kallëzimit për të gjitha rastet ndërtimi pale, që është kompetencë e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit pranë bashkive, natyrisht edhe në nivel qendror me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. Pjesë e cila ka nevojë, besoj që të ketë një rikonfigurim të aspektit ligjor dhe patjetër që duhet të jetë, besoj. Duhet të isha shumë i lumtur që do të ishte pjesë e diskutimeve dhe brenda kuadrit ligjor ose paketës ligjore që do të mbështesin reformën e pritshme administrative territoriale. Lidhur me numrin e punonjësve, sepse është një debat gjithmonë që bëhet krahasimi. Dhe këtu ishte pika që patjetër duhet të referohemi edhe numrit të punonjësve që ka pasur bashkitë ose ish-komunat në raport me numrin e punonjësve aktualë dhe unë po të marr një shifër. Ndryshimi nga 2015-a deri sot, në bashkinë Malakazë është 28 punonjës në totalin e vet dhe këtu po flas duke përfshirë të gjithë punonjësit dhe administratën. Ka pasur 323 në 2015-in që kuptohet ishte pjesë së bashku me gjithë stafet e ish-komunave. Sot ka 351 që janë në funksion dhe ajo çfarë është e rëndësishme ose ajo që përgjithësisht në momente të caktuara devijohet nga e vërteta që nuk kemi rritje të administratës, por kemi rritje të punonjësve të cilët janë në funksion të shërbimeve, kryesisht nën marrjet e shërbimeve publike, pavarësisht emërimit që kanë në bashki të ndryshme. Këto zënë zërin kryesor të shërbimeve nga 351 në bashkinë Malakazë, pjesë e ndërmarrjes së shërbimeve publike, së bashku me pjesën e punonjësve pranë njësive administrative, por që lidhen me shërbimin janë diku te 223, mos gaboj, punonjës nga totali i të gjithë pjesës tjetër. Patjetër që duke rritur shërbimin ke nevojë të kesh edhe shtesë fuqi punëtore, sepse në rast se dikur Malakaza, konkretisht ishte shërbimi pasiv, vetëm qytetin e Malakazës, sot e kanë 80% të territorit me synim që do të shrihet deri në 100%, por kjo ka nevojë për shtesë fuqi punëtore. Në rast se infrastruktura rrugore mirëmbahet me një numër shumë të vogël punonjësish dhe duke shtuar aksat rrugore dhe infrastruktura rrugore, patjetër që ka nevojë që të ketë një fuqi punëtore shtesë brenda normativave të përcaktuara që duhet të ketë dhe sa për ta përmbyllur këtë pjesë të diskutimit. Unë do të bëj një krahasim me 2 ish-komuna me financimet që kanë pasur në atë periudhë me të ardhura që realizonin. Komuna Kutë, Malakazë, ku unë kam qenë kryetar i komunës Kutë. Me të ardhura vendore. Në vitin më të mirë, 2.2 milionë lekë të reja. Dhe komuna Graçan. Një komunë që ka pasur diku te 1200 banorë në totalin e vet që shkonte 1.2, 1.3 milionë lekë të ardhura me të ardhurat e bashkisë sot. Janë investuar në vetëm këto 2 komuna, në komunën Kutë, 1.2 milionë. Më fal, 120 milionë lekë të reja në infrastrukturën rrugore, ndërsa në njësine administrative Graçan është një investim prej 100 milionë lekësh të reja, 1 miliard lekë të investuar nga të ardhurat e bashkisë. Në të dyja rastet, komuna Kutë donte minimalisht që të kryente këtë investim, donte të paktën diku tek 20, 30 vjet ose 40 vjet. Ai bie që mos bëj gabimin matematikor. E njëjta gjë edhe për komunën Graçan. Dhe besoj që kjo reformë administrative është një ndihmesë jashtëzakonisht e madhe për qytetarët dhe shërbimet qytetare. Se ne harrojmë një element tjetër e lidhim me...

### **Luçiano Boçi:**

Zotin Ismailaj. Ju lutem, fal, ja një ndërprerje, ja një ndërprerje e vogël, sepse këtë formulën që ne kemi bërë, një investim i cili s'do bëhesh kurrë edhe për 20 vite, diku e

kemi dëgjuar dhe 500 vite. A mundet na e jepni atë ekuacionin si e nxirrni ju këtë? Se jam shumë kurioz, domethënë kam kaq vite në politikë dhe s'e kam gjetur si e nxirrni ju këtë që kjo rrugë s'do bëhesh për 20 vite, domethënë mbi bazën e kujt? Parametrave, faktorëve. Shumë e thjeshtë, shumë e thjeshtë, sa më thjeshtë se normal po mendon e thjeshtë, mendon fushë.

### **Qerim Ismailaj:**

Komuna Kutë realizonte me të ardhurat e veta 2.2 milionë lekë në vitin 2014. Investimi kryer nga Bashkia Malakazë sot me të ardhurat e Bashkisë Malakazë, nuk po flasim këtu as grante, as transferta, asnjë. Ka kaluar shifrën e 1.2, 120 milionë lekë dhe 1.2 miliardë lekë të vjetër dhe kjo është realizuar nga të ardhurat e bashkisë. Ndërsa vetë komuna me të ardhurat i kishte ajo komunë. Pjesëtoni, bëni pjesëtimin. 120 milionë lekë me 2.2 milionë lekë, ndodh sa i vete 50 e kushtojnë.

### **Luçiano Boçi:**

Po ta jap punë, po ta jap punë kundërpërgjigjen e kësaj formule. Po, ekziston, jo meqenëse ishim te formula, ekziston bashkëpunimi ndërbashkiak. Dhe sikur këto komunat ishin bashki të vogla me bashkëpunimin e tyre, se ti harron që e bën llogarinë totale, e bën në raport me një komunë, po i ke hequr drejtën komunës tjetër që do mbledhin të ardhurat. Po, pra po ke më shumë komuna, ja ke hequr drejtën që i bie që këto do e marrin investimin pas 10 vitesh, apo jo? Se ju keni 12 vite në këtë standard dhe një komunë paska marrë një rrugë dhe ky që e ka suksesin në 12 vite, një rrugë dhe këtu u definuaj gjithë sukcesi i pushtetit lokal dhe këto krahasime na i kurseni, sepse ka qenë një nga ndërhyrjet e mia në fillim. Thashë me ju se pata mundësinë, po mos i bëni këto krahasime, krahasime se ka 12 vite ky pushtet t'i thuash njerëzve për 12 vite ju kam bërë një rrugë unë dhe këtu ka mbaruar gjithçka. Shërbimi im ndaj jush më duket e tepërt se 12 vite është 1 e treta e kohës demokracisë. Mos e bëni në këtë lloj forme, se nuk shkon...

### **Qerim Ismailaj:**

Dhe nuk përmenda investimet e tjera në mbajtjet e shkollave, në infrastrukturën rrugore, mirëmbajtjen rutinë, mirëmbajtjen e varrezave. Nuk përmenda këto. Përmenda thjesht një shembull për të konkretizuar, ndërsa ajo çfarë është e rëndësishme sot bëhet copëzimi për një arsye: shërbimi ndaj qytetarit, shërbimi, lidhja e qytetarit me kryetarin e bashkisë është institucional, nuk është fizike. Fizike, kryetari i bashkisë, unë fatmirësisht e njoh territorin e bashkisë Malakazë në çdo cep, por ama qytetari nuk e ka lidhjen me kryetarin, e ka lidhjen me shërbimin. Ai do shërbimit dhe shërbimi krijohet me këtë njësi administrative të organizuar. Nuk mund të jetë e copëzuar. Kam qenë kryetar komune dhe nuk kisha mundësi të ndihmoja për të shtruar një rrugë për në varreza, sepse ajo që ishte mundësia financiare, ndërsa sot bashkitë me këto mundësi që kanë me ndërmarrjet e krijuara, me asetet, ndërmarrjet e mjeteve që ka pothuajse çdo bashki, çdo kohë i përgjigjet kohë reale pjesës dhe asaj çfarë kërkon qytetari. Në fund të ditës, besoj të gjithë biem dakord që këtu ne jemi për të diskutuar se si ta bëjmë më mirë shërbimin ndaj qytetarit dhe unë besoj që kjo lloj reforme, kjo lloj organizimi, kjo lloj ndarje, natyrisht

çështja e kompetencave. Se çfarë kompetencash duhet të ketë bashkia, çfarë duhet përmirësuar, çfarë duhet shtuar, a duhet të kenë njësitë administrative disa kompetenca më tepër? Patjetër që do të isha favor nëse administrative të delegoheshin disa kompetenca nga bashkia qendrore. Është një debat që mund të vazhdojë dhe të diskutojë edhe në nivel ekspertësh, se patjetër që ka plot të tjerë që kanë përvojë në pushtet lokal, por ajo çfarë është kjo do të funksionojë si njësi administrative e unifikuar me këtë territor aktual që është, sepse në rast se do të kemi copëzim, do të kemi copëzim burimeve njerëzore, do të kemi copëzim të mjeteve dhe në fund ajo çfarë do të jetë, do të jetë një mungesë shërbimi ndaj qytetarëve, atë të cilët ne synojmë ta përmirësojmë çdo ditë. Faleminderit.

### **Xhelal Mziu:**

Zoti kryetar, po jap një moment. Na dha një shifër, thotë kemi ndërtuar një rrugë 120 milionë ose 1.2 miliardë, sa morëm vesh. Megjithatë, unë po ju referoj një shkresë të Ministrisë së Financave, ku thotë: "Në vitin 2015, 307.3 njësi vendore kanë kontribuar me 37.5% për investime kapitale." 37.5%, fiksoj këtë. Në vitin 2024, se nuk ka dalë 2025-a, kanë shkuar për shpenzime kapitale vetëm 19.5%. Pra, çfarë do të thotë? Atë se çfarë ju thoni, pra që ta kuptojnë dhe qytetarët shqiptarë, në 100 lekë, kur kishim 307.3 njësi vendore, 37.5 lekë shkonin për investime, ndërsa kur u bëmë 61 bashki, shkojnë vetëm 17.5 lekë. Dhe çfarë do të thotë? Flitet për 11 vite, zotëri. Janë buxhetet mbyllura për 9 vitet. Se kemi vetëm të dhënat vetëm deri në 2024-n. Pra, çfarë do të thotë që qytetarët shqiptarë kanë nevojë për një pushtet vendor që bën investime dhe bën dhe shërbime, jo se sa persona ka? Dhe po të them po prapë referencën tjetër: shkonin për paga dhe sigurime shoqërore 31.1% ose 31.1 lekë. Në 100 lekë shkonin për paga dhe sigurime shoqërore. Në vitin 2024, 45.7 lekë ose 15.5% e buxhetit shkonte për paga dhe sigurime. Këtë e thashë, jo, nuk mund ta merrni më fjalën. E thashë për të treguar, për të treguar, për të treguar. Po pra, po. Të tregova, të tregova shifrat tuaja, shifrat tuaja që nuk janë, nuk janë koherente, nuk janë koherente, nuk janë koherente. Kështu që, kështu që të japim fjalën Mailindës. Unë i kam bërë pyetjet unë. Po unë i kam bërë pyetjet, mos e dëgjova atë? Po s'ka lidhje fare me ajo që folët ju. Unë të dhashë një tendencë dhe nuk, unë të dhashë tendencë.

### **Qerim Ismailaj:**

Po të kthej thjesht një përgjigje, sepse ju referova asaj të cilës u thashë dhe aty morët një referencë që është nga Ministria e Financave. Natyrisht, nuk kam drejtë të dyshoj në vërtetësinë e asaj shkrese, por ajo të cilën unë mund të them dhe të përgjigjem është e thjeshtë fare. Natyrisht, e shpjegova pak, ju anashkaluat në komentin tuaj. Në qoftë se do të rritësh shërbimin, do të rritësh ndërmarrjet e shërbimeve, patjetër që do të kesh detyrimisht një fuqi punëtore shtesë. Në qoftë se do të rritësh mjetet, natyrisht do të kesh nevojë për mirëmbajtjen e këtyre mjeteve, shpenzime të tjera, por mos ta analizuar më gjatë. Por unë po them konkretisht në Bashkinë Mallakaster, natyrisht që të kem shifrat e sakta për këtë nuk i kam, por gjithsesi çdo kohë i vë në dispozicion. Raporti është shumë më pozitiv sesa ai që më krahasuat në 2014-ën. Besoj që jemi në raportin shpenzimet për

shkojnë diku te 28% për pjesën e administratave, punonjësit dhe pjesa tjetër është shpenzime kapitale dhe patjetër edhe shpenzime mirëmbajtjeje, ato që përmendëm më parë. Pra, është e rëndësishme të theksohet jo vetëm aspekti, sepse këtu është edhe përqindja, por duhet të theksojmë edhe një aspekt tjetër. Kjo reformë çfarë ka bërë të mundur që të rriten të ardhurat do të. Edhe në shifra konkrete sesa janë investimet, sepse vërtet përqindja ndryshon për arsye të ndryshme, por njëkohësisht duhet të shohim që në qoftë se dikur investojsh nga bashkitë dhe komunat 100 lekë nga të ardhurat e veta, sot në shifrën nominale jam i bindur që kjo shifër është diku tek 200, 250, 300, për mos thënë më tepër. Jo, nuk abuzoj, të lutem, nuk kam, nuk kam pse abuzoj. Besoj që ta shpjegovash, shpërndarja është e tillë, okej.

### **Fation Duro:**

Përshëndetje. Po, po, zotëri Duro. Po, të nderuar deputetë. Faleminderit për pjesën e sotme. Në fakt, për sa i përket Bashkisë së Patosit, unë u ndava vetëm te performanca financiare e saj, duke qenë se Bashkia e Patosit sot që ne flasim, borxhet i ka në nivelet 0. Pra, është një bashki që performon shumë mirë nga ana financiare dhe jo vetëm. Ndërsa për sa i përket pyetjeve, te pyetja e 1-rë, 2 dhe 4. Në fakt, mendoj që janë pyetje të rritura. Normalisht, besoj se ka një kryetar bashkie që mos dojë që të rriten të ardhurat për qytetarë. Për bashkinë dhe detyrimisht do të kthehen investime për qytetarë. E njëjta gjë është dhe pyetja e 3-të. Pjesërisht. Pasi, normalisht, disa delegim kompetencash mund të kishin një mbështetje financiare disi më të madhe, siç është MNZ-ja. Por kjo mbështetje financiare mund të kufizojë dhe në një periudhë të shkurtër kohe për bashki dhe mos vazhdonte për një periudhë të gjatë kohe. Deri në momentin që bashkitë të rrisnin flotën e tyre të mjeteve për mbrojtjen kundër zjarrit. Ndërsa për pjesët e tjera varet edhe nga tipologjia e bashkisë. Disa bashki mund të kenë nevojë më shumë për rritje të mbështetjes financiare tek kanalet e pullullës, ndërsa disa të tjera tek delegim kompetencash të tjera që janë bërë nga ana e qeverisë. Ndërsa për sa i përket dublimit të kompetencave, mendoj që ju përmendët pjesën e ndërtimit të paligjshme. Normalisht, vetëm nga vetë emri, ndërtimi i paligjshëm, normalisht automatikisht futet edhe policia këtu, se është diçka që është e paligjshme dhe normalisht IMT-të e bashkisë mundohen që ta kontrollojnë territorin, por në qoftë se do të ketë një mbështetje, në qoftë se ka, siç edhe realisht ka mbështetje nga ana e policisë së shtetit, normalisht që është e mirëpritur, pasi dhe vetë policia e shtetit, nga natyra dhe funksionimi i saj, e ka më të lehtë për të kontrolluar territorin sesa vetë inspektorati i bashkive. Për lejen e ndërtimit për ndërtesa mbi 5 kate, nuk mund të flas, pasi Bashkia e Patosit nuk është se ka pasur ndonjë kërkesë për ndërtime mbi 5 kate. Ndërsa për sa i përket rrugave, normalisht mendoj që ka qenë një vendim i drejtë rritja e rrugave. Mbase duhet të ishte bërë edhe më herët. Pasi, sidomos jo vetëm bashkitë e vogla, por mendoj dhe bashkitë e mëdha. Po, po. Numri i punonjësve dhe rrugat janë dy gjëra të ndryshme. Mund të rriten rrugat dhe të ulet numri i punonjësve. Po, kjo është e drejtë. Mund të. Por në qoftë se nuk je kompetitiv, e vetmja ofertë që ne mund t'i ofrojmë punonjësve është vetëm paga. Dhe, duke rritur pagat, bashkitë janë bërë kompetitive edhe me privatin dhe në këtë mënyrë janë afuar drejt bashkive dhe punonjës më të kualifikuar, duke e bërë të mundur dhe kryerjen e detyrimeve të tyre funksionale më mirë se ç'mund të bëheshin më herët. Për sa i përket mos

përfaqësimit të komunave që u përmendët në fund, unë mendoj që përfaqësimi më i mirë i komunave nuk është duke çuar i komunave ose ish-komunave. Nuk mendoj që duhet të jetë që t'i bësh përsëri ato komuna, por duke vajtur tek ato 3 pyetjet e 1-ra që ju bëtë me rritjen e mbështetjes nga ana e qeverisë për bashkitë, ne automatikisht i përfaqësojmë dhe më mirë ata qytetarë, pasi qytetarët nuk është se duan që të vemi ne atje t'i çajmë hallet bashkë me ta. Edhe t'i delegojmë këto halle. Qytetarët duan përfaqësimin më i mirë që ne mund t'i bëjmë atyre duke investuar tek zonat e tyre. Ne investojmë me aq mundësi sa kemi me të ardhurat e bashkisë që kemi. Bashkia e Patosit, mos gaboj, nga të ardhurat e veta mbulon afërsisht gjysmën e buxhetit të saj nga të ardhurat që mbledh vetë bashkia. Dhe mendoj që përfaqësimi më i mirë është investimi i qytetarëve dhe jo thjesht të ketë një komunë atje apo një bashki që të çajë hallet bashkë me qytetarët. Kur më e mira është të shtohen investimet duke shtuar ato 3 pyetjet e 1-ra që bëtë ju. Faleminderit.

**Luçiano Boçi:**

Po, zonja Bufi.

**Majlinda Bufi:**

Faleminderit. Unë e shikoj si një mundësi shumë të mirë këtë takim të sotëm. Por nuk më vjen mirë që fillojmë me këtë lloj fyerje ndaj nesh. Sepse nëse është kryetari i bashkisë tjetër, mos e shihni as ne. Sigurisht, më fal.

**Luçiano Boçi:**

Nuk është fyerje. Jo, nuk është fyerje. Të lutem, mos ndërhyj. Jo, po jam drejtuesi. Të lutem, unë s'e kam ndaj jush. Do ndërhyj në të mirë të menaxhimit të punës së komisionit. Të lutem, ju lutem, unë juve.

**Majlinda Bufi:**

Unë mendoj që...

**Luçiano Boçi:**

Dhe njëherë, zonja Bufi, se ke qenë dhe parlamentare. Unë mendoj... Zonja Bufi, dhe njëherë se nuk e kam për autoritet për mbarëvajtjen e komisionit. Nuk është aspak fyerje kërkesa e deputetit Baçi. Është një kërkesë... Më dëgjo, çfarë do them deri në fund. Është një kërkesë... Mendoj që duhet të më dëgjoni deri në fund, pastaj të më gjykoni. Dhe njëherë e menaxhoj unë në këtë rast komisionin. Dakord, po dakord, po tani prit njëherë se e ka një fillim komisioni edhe e ka edhe një vazhdim. Dhe unë po e sqaroj, nuk do ndërhyjmë kështu në konfliktualitet personal duke përdorur një argument që është argument parlamentar dhe është e marrë si problematike edhe nga ne, jo në këtë rast, por edhe në një rast tjetër kemi pasur mungesë kryetarin e bashkisë, Soel Basanin. Më dëgjo me vëmendje. Dhe madje deputetët tanë ishte precedent, ishte rasti i parë kërkuan ndërprerjen e mbledhjes dhe me vendim zoti Baçi nuk është anëtar i komisionit, anëtar i përhershëm, ka ardhur si deputet i qarkut Fieri dhe vendosëm që ta thërrasim në një

seancë tjetër në vazhdimësi. Dhe në këtë rast zoti Baçi përsëriti të njëjtën kërkesë që kemi thënë ne për Elbasanin që mos vazhdojë, sepse ne duam që të jenë të gjithë kryetarët e bashkive, se flasim për një qark që ka të gjitha bashkitë dhe kanë korrelacion me njëri-tjetrin. Nuk është se ndajnë kufij dhe aty është vendosur një ndarëse e pakomunikueshme. Për të mirën e punës, se kemi dashur që të jenë të gjithë kryetarët e bashkive, kështu që mos vazhdojmë me gjëra të tilla, se nuk na shërben.

### **Majlinda Bufi:**

Mund të na e kishte kursyer atë fjalën e fillimit, sepse unë mendoj që çdo kryetar bashkie në çfarëdo lloj bashkie ku punon, ku është zgjedhur nga qytetarët, ndeshet me të njëjtat problematika. Qoftë bashki e madhe, qoftë bashki e vogël, qoftë periferike, qoftë në qendër, kërkesat e qytetarëve janë të njëjta. Dhe detyrimi i kryetarit të bashkisë me stafin e vet është që të përmirësojë shërbimet ndaj këtyre qytetarëve. Ky është objektivi dhe ne jemi mbledhur sot këtu dhe për këtë qëllim, dhe qëllimi i reformës territoriale është pikërisht ky. A duhet të përmirësojmë shërbimin ndaj qytetarëve? Prandaj, prandaj shërbejnë këto takime për të bërë një gjë të mirë dhe mua më vjen mirë që në këtë komision është dhe zoti Nziu, i cili ka qenë kryetar i bashkisë së Kamzës për vite me radhë. Ka performuar mirë atje në kohë, ka bërë plot punë, por dua t'i kujtoj zotit Mziu që sot jemi shumë vite. Kur kompetencat, funksionet nuk janë të njëjta me ato që kanë qenë atë kohë. Dhe padyshim që jemi 10 vite pas 2015-ës, kur filloi kjo reforma e 1-rë, emiratuar, në të cilën unë kam qenë pjesë. Dhe sigurisht unë do të thoja me plot gojë që situata nuk është e njëjtë siç ka qenë. Sigurisht që ka progres. Ka progres në mënyrën se si japim shërbimet, në mënyrën se si ne mbledhim të ardhurat dhe rrisim buxhetet tona. Por jam shumë e bindur që ka edhe problematikë. Ashtu siç i konstatojmë ju problematikën, sepse e keni të drejtën tuaj si opozitë që jeni të shikoni atë që nuk shkon jo vetëm në pushtetin lokal, por në gjithë sjelljen dhe jetën e qytetarëve të Shqipërisë. Edhe ne i konstatojmë këto probleme, por nuk mund të themi që nuk ka progres. Ka progres dhe unë do përmend vetëm 2 referuar bashkisë, të cilën unë përfaqësoj këtu. Në Roskovec, sot për shembull, ne arrijmë ka disa vite që buxhetin që krijojmë me të ardhurat tona ta kemi më të lartë nga ajo që marrim nga qeveria. E kemi më shumë se 50% çfarë krijojmë vetë, çfarë mbledhim vetë, qoftë nga bizneset, qoftë nga qytetarët, më shumë se ajo që marrim nga qeveria dhe kjo është arritje. Është kjo një arritje për shkak të reformës, është kjo një arritje për shkak të menaxhimit më të mirë, të le ta gëzojmë, por ama kjo është një arritje dhe kjo ndodh në Roskovec. Hapini shifrat, shikojmë. E 2-ta, një arritje që është përsëri sipas shifrave të institutit. Bashkia e Roskovecit ka disa vite që është kualifikuar në 10 bashkitë ku të ardhurat për frymë janë më të lartat në vend. Dhe kjo ka ardhur për shkak edhe të reformës territoriale, sepse për atë që ne u kemi dhënë qytetarëve në shërbime, në investime dhe jo vetëm në qendër të bashkisë, por në të gjithë territorin, në çdo qendër të njësi administrative, në çdo fshat, ne kemi sot sera vetëm të shtuarit 300 hektarë më shumë nga ç'kemi gjetur në 2015-ën. Po pse ndodh kjo? Kjo ndodh sepse fermerët atje kanë arritur të krijojnë besim në dhënien e shërbimeve, kanë arritur të krijojnë besim që e kanë të garantuar shërbimin e ujitjes dhe të kullimit dhe prandaj kanë investuar në tokat e tyre. Padyshim me lekët e tyre kanë investuar, por kanë investuar për shkak të këtij besimi të rritur dhe kjo është një arritje që ka ndodhur edhe për shkak të reformës

territoriale. Pra, mjaftojnë këto 2 argumente pa u futur në detaje për të thënë që rast pas rasti, sigurisht ndoshta jo në nivelin e përgjithshëm, jo të gjitha bashkitë performojnë njëllë, jo të gjitha kanë të njëjtat burime natyrore, jo të gjitha kanë të njëjtët kapacitete njerëzore edhe menaxhuese për të arritur rezultatet më të mira, por ama sigurisht që ashtu siç kemi raste jo të mira, jo pozitive që ju i keni gjetur, ashtu ka dhe raste shumë të mira. Pra, kjo reformë territoriale padyshim që ka dhënë efektet e veta, por a jemi aty ku do donim të ishim? Sigurisht që jemi. Unë besoj që ka vend për përmirësim. Ju përmendët zoti Nziu një sërë kompetencash të deleguara, funksionesh, bëtë pyetje në lidhje me financat, me taksat, me dublimin e kompetencave. Patjetër që po. Ne nuk mund t'i fshehim që a ka probleme te lejet? Po, nuk i japim me leje sot. A kemi probleme te kontrolli i territorit? Po, është edhe policia e përfshirë. A do ishte më mirë të ishte vetëm bashkia? Unë mendoj që në disa bashki po, në disa jo, sepse jo të gjitha bashkitë kanë të njëjtën kapacitet. Thashë edhe për shkak të burimeve njerëzore, edhe për shkak të burimeve natyrore, edhe për shkak të madhësisë së territorit. A ka momente ku bashkitë sot janë shumë të mëdha në territor? Po, ka. Le të shikojmë këto raste, ashtu siç jam shumë e bindur që ne nuk duhet t'i shkrijmë ato bashki ku, edhe pse janë larg qendrave, kanë shumë pak banorë. Ne duhet t'i shkrijmë? Jo, nuk duhet t'i shkrijmë. Sepse në qoftë se sot, për shembull, atje ka një fenomen që kemi të bëjmë me largimin e popullatës së njerëzve, në qoftë se ne do ta shkrijmë bashkinë, ata do ikin dhe ata që janë atje. Ne duhet të përpiqemi si ta përmirësojmë dhënien e shërbimit nga qendra e bashkisë tek banorët ku ata që banojnë. Banorët kanë të drejtën e tyre të jetojnë atje ku ata duan, atje ku kanë traditën, atje ku kanë pronën e tyre, shtëpinë e tyre, njerëzit e tyre dhe na takon ne, pushtetit lokal, qeverisë qendrore që si ta përmirësojmë këtë gjë. A kemi ne probleme me buxhetin? Patjetër që po. Në vitin 2015, tha zoti Nziu, ka qenë 1% e GDP-së. Po, aq ka qenë. Pra, sot ka rritur 3.5%. A duhet të ishte më shumë se kaq referuar dhe krahasuar kjo me rajonin? Patjetër që po. Unë jam shumë e bindur që gjithë ato që thatë ju, çdo kryetar bashkie do donte t'i kishte, të kishte më shumë financa, të kishte kompetenca më të qarta. Por prandaj jemi këtu. Prandaj duhet ta shikojmë këtë reformë me syrim pozitiv dhe me një qasje pozitive, jo vetëm nga ne, por edhe nga opozita, që si ta përmirësojmë këtë gjë dhe jo ta njollosim atë që është bërë dhe ta nxijmë atë që është bërë, por se si përmes defekteve që ne konstatojmë të gjithë së bashku sot, ne t'i përmirësojmë këto gjëra. A duhet t'i qartësojmë kompetencat? Po, patjetër. A kemi ne raste kur kompetencat kanë ardhur dhe s'na kanë ardhur lekët? Po, patjetër që ka. U përmendën nga kolegët, i dimë dhe ne dhe të gjithë. I përmendi zoti Nziu dhe unë nuk dua tani të filloj me radhë çfarë ndodh me zjarrfikësin, çfarë ndodh me shërbimin parashkollor, çfarë ndodh, ku e di unë, me pyjet. Patjetër që ka probleme këtu, sepse çdo kompetencë dhe çdo funksion që delegohet e pushtetit vendor duhet të shoqërohet me financa. Në disa raste kanë qenë të mirë deleguara, në disa raste të tjera jo. Dhe unë nuk mund ta fsheh këtë gjë. Unë jam në fund të mandatit tim të 3-të edhe sipas ligjit, sigurisht që nuk do të kandidoj më në atë zonë dhe mund ta them pa frikë dhe pa asnjë konflikt interesi që reforma territoriale ka nevojë për rishikim. Aty ku territoret janë të mëdhaja, sigurisht që duhen të sillen më pranë qytetarëve, por aty ku njësitë janë, duhet të bëhen më efektive. Unë mendoj dhe kam një mendim konkret timin, referuar dhe asaj që unë njoh modeleve të tjera sot, jo vetëm në rajon, por edhe në vendet me demokraci më të zhvilluar në botë, në Evropë kryesisht, në

vendet e ulëta. Unë do doja që në Shqipëri të kishim 2 nivele të qarta të qeverisë vendore: nivelin e poshtëm që ka të bëjë me bashkitë dhe nivelin e mesëm, atë që ka të bëjë me rajonet, qarqet, jo prefekturat, më fal, rajonet, qarqet, vëreni emrin si të doni. Mund t'ia vëmë emrin rajon, mund t'ia vëmë emrin qark, por duhet të kemi 2 nivele të qarta të ndara në kompetenca. Çfarë i takon të bëjë bashkia si niveli më i ulët pranë qytetarëve për të dhënë shërbimin që i duhet 1 të moshuarit kudo që ai ekziston, 1 parashkollori, 1 fëmijë në kopsht kudo që ai banon me familjen e vet, 1 fermeri për ujitje dhe kullimin ku ai ka nevojë për të zhvilluar biznesin e vet në bujqësi, për të zgjidhur 1 konflikt midis 2 banorëve kudo që ata jetojnë, edhe në fshat, patjetër që po na duhet niveli i poshtëm. Bila na duhet edhe më i detajuar se ç'e kemi sot, por ama me kompetenca të qarta, me udhëzime, me ligj të qartë, në mënyrë që 1 kryetar bashkie, 1 punonjës të dijë se ku shkon, të jetë i qartë në funksionin e vet për të zgjidhur konfliktin apo kompetencën që ai shkon atje dhe padyshim 1 nivel tjetër më të qartë në nivelin e mesëm të rajonit, i cili po të ketë ligjshmërinë e duhur, po të ketë kompetencat e duhura, jam shumë e bindur që do ketë dhe burimet njerëzore të duhura. Si mundet, për shembull, në 1 bashki, jo si edhe si Roskovecit? Unë s'jap dot, nuk i kam kapacitetet për të dhënë lejet e ndërtimit për, ku di unë, pallatet lart, sepse nuk ka realisht. Unë kam agronomë për të bërë ndoshta për të zgjidhur 1 problem me bujqësinë. Por a nuk do ishte më mirë që këto kompetenca që kërkojnë 1 nivel më të lartë profesionalizmi të mbledheshin qartazi për rajon? A i duhet sot Shqipërisë kjo gjë? Unë mendoj që po. Ne kemi bërë shumë eksperimente. Edhe kur nuk kemi qenë fare në politikë, edhe më përpara. Edhe kur s'ka qenë zoti Nziu, edhe kur s'kam qenë unë. Sot ka ardhur momenti që me eksperiencën, me modelet që kemi, edhe ndoshta njëherë me dështimet pa dashje të njëri kah apo të tjetrit kah politik, ka ardhur momenti që përmes kësaj reforme të riparojmë ato gabime që kemi bërë, ato gjëra që nuk kanë vajtur mirë dhe ta rregullojmë qasjen ndaj qytetarëve, qoftë ky i majtë apo qoftë i djathtë, dhe kjo gjë duhet të artikulohet qoftë nga unë si kryetare e bashkisë së majtë, qoftë nga 1 kryetar i djathtë, qoftë nga 1 kryetar, deputeti i majtë apo i djathtë. Për t'u shërbyer qytetarëve aty ku ata kanë nevojë. Faleminderit shumë.

Po fjalën? Po, zonja Bylykbashi. Pastaj zoti Baçi.

### **Aulona Bylykbashi:**

Faleminderit bashkëkryetar. Nderuar kryetar. Sigurisht që i gjithë diskutimi, ashtu si kundër, edhe zonja Bufja e përmendi tashmë së fundmi, i kësaj reforme nisët duke u bazuar tek ky tema dhe a i marrin sot qytetarët shqiptarë shërbimet në nivelin që kanë të drejtë t'i marrin dhe çfarë për t'u përmirësuar. E padyshim, kur flasim për 1 reformë, ne flasim sot për 1 reformë e cila ka dhënë rezultate në të gjithë Shqipërinë dhe padyshim kemi dhe 1 sërë, le të themi, faktorësh apo elementësh të cilat koha i ka nxjerrë në pah dhe ka treguar që kanë nevojë për t'u rishikuar. Kjo është arsyeja pse jemi sot këtu gjithë bashkë. Unë do nis pyetjen time duke bërë për ju 1 pyetje krahasimore në raport me. E 1- ra se si janë sot treguesit e performancës financiare të secilës bashki, duke u nisur në 1 shkallë krahasuse para reformës së vitit 2015 me atë sot. Dhe pyetja tjetër ka të bëjë se cilat janë ato shërbime që ofrohen sot nëpër njësi administrative, të cilat nuk janë pasofruar nga ish-komuna, apo edhe në invers, nëse kemi raste të tilla ku ka pasur 1 sërë

shërbimesh që ofroheshin nga ish-komuna dhe sot nuk ofrohen më për të bërë 1 krahasim ndërmjet të 2 modeleve të menaxhimit. Dhe pyetja e 3-të lidhet me sa nga kompetencat tuaja si kryetar bashkie keni deleguar ju tek administratorët e njësive administrative dhe mendoni që delegimi i këtyre kompetencave në 1 masë të caktuar do ta përmirësonte dhënien e shërbimit më afër qytetarit në njësitë administrative, meqë është 1 çështje shumë e diskutuar kjo e lartësisë së territorit, sepse unë mendoj që lartësia territoriale nga qendra e bashkisë, jo domosdoshmërisht, bëhet pengesë për ofrimin e shërbimeve. Nëse ne kemi 1 formë të mirë menaxhimi nga ana e, le të themi, e strukturës qendrore, që padyshim është kryetari i bashkisë me njësitë administrative dhe administratorët, duke qenë se gjithmonë është ngritur ky koncepti i mungesës së përfaqësimit, po sot qytetarët përfaqësohen, sepse janë ata që zgjedhin kryetarin e bashkisë. Këshillat bashkiake që përfaqësojnë padyshim dhe rolin më pranë tyre ushtron 1 funksionar i emëruar nga kryetari i bashkisë dhe nga krahu tjetër, kryetari i bashkisë ka të gjithë në dorë mundësinë për të rregulluar qoftë administrimin, por edhe për t'i deleguar atyre 1 sërë kompetencash, në mënyrë që kryetari i njësisë punëtorët mos detyrohet të shkojë deri në qendër të bashkisë dhe nuk është e nevojshme, ashtu si kundër, edhe kryetari i madhakalësisë me ata që të ketë 1 kontakt fizik të qytetarit me kryetarin e bashkisë, por duhet të ketë 1 formë administrimi të mirë për të shkuar atje shërbimi. Këto ishin pyetjet e mia. Faleminderit.

#### **Fation Duro:**

Deputetë, faleminderit për pyetjen. Për sa i përket treguesve financiarë të bashkisë së Patosit, unë e thashë dhe tek përgjigjja e 1-rë. Bashkia e Patosit është 1 bashki që sot i ka 0 borxhet ndaj të tretëve në operator ekonomik. Nuk kemi borxhe si bashki. Ndërsa për sa i përket vjeljes së vjeljes së taksave, mund të them që të ardhurat vjelja e taksave në bashkinë e Patosit për numrin total të taksapaguesve është e mirë, ndërsa për sa i përket për ata tatimpagues që banojnë aktualisht në bashkinë e Patosit, është shumë e mirë. Dhe në vlerë totale të buxhetit të bashkisë së Patosit, të ardhurat nga të ardhurat e veta janë në nivelin mbi 40%, po mos gaboj. Nuk mund të them dot se sa kanë qenë para vitit 2015, pasi është 1 informacion që unë nuk e kam sot, pasi nuk e di aq sa do të na duhej si informacion. Por të paktën të ardhurat nga 2023-i që unë i kam marrë sot me vete deri sot që ne flasim, të ardhurat e të ardhurat nga taksat e bashkisë së Patosit kanë ardhur duke u rritur. Në vlerë, ndërsa në përqindje kanë qenë 51, 49, 48, 47, kjo për shkak jo sepse kanë rënë të ardhurat, jo sepse kanë rënë të ardhurat nga taksat, por sepse është rritur transfertë nga buxheti i shtetit dhe normalisht përqindja lëviz, por në vlerë. Leku të ardhurat nga taksat janë rritur çdo vit, pothuajse. Për sa i përket delegimit të kompetencave tek administratorët e institucioneve bashkiake, unë personalisht nuk kam deleguar kompetencat e kryetarit të bashkisë, madje as tek punonjësit kryetarë apo tek punonjësit të tjerë të bashkisë. Nuk i kam deleguar. Kjo është zgjedhja ime. Ndërsa në qoftë se do të delegoheshin këto kompetenca tek administratorët e institucioneve administrative, nuk mund të them dot. E kuptoj, e kuptoj. Po. Për sa i përket kësaj pjese, për sa i përket kësaj pjese, tek të paktën për bashkinë e Patosit, tek të dyja institucionet administrative merren kërkesat dhe ankesat e qytetarëve dhe më pas sillen në bashkinë e Patosit, mbase jo vetëm fizikisht, por edhe nëpërmjet telefonit për ato ankesa që janë që mund të zgjidhen për 1 kohë shumë të shkurtër, duke ulur edhe kohën e marrjes së

shërbimit të qytetarëve. Ndërsa për sa i përket edhe për lejet e për vetëdeklarimet, qytetarët e bëjnë kërkesën te njësi administrative, por leja del nga ana e bashkisë. Edhe për shkak të numrit të vogël, nuk është se kemi numër shumë të madh kërkesash për leje. Deri tani na ka funksionuar. Mund edhe të nisem me pjesën e të bëj 1 krahasim. Të flas për periudhën që kam qenë unë. Në qoftë se para 3 vitesh, në bashkinë e Patosit, çdo të enjte bëhet pritje me qytetarët. Pjesa më e madhe në 2023-in, le të themi që kam filluar unë. Mund të shkonte 1 numër edhe 78 qytetarë në ditën e enjte që bëhej pritja me qytetarët. Kryesisht ishin problematika të lidhura me infrastrukturën. 1 pjesë e mirë ishin edhe problematika të lidhura me pjesën e ujësjellësit. Rrjetin e kanalizimeve. Ne si bashki kemi zgjedhur që 1 pjesë të investimeve t'i bëjmë me vetëpunonjësit e bashkisë, Agjencinë e Shërbimeve Publike. Kjo për efekt kosto, duke qenë se kostoja e investimit bërë nga me punonjësit e bashkisë është shumë herë më e ulët se sa investimi me të tretë. Edhe kemi arritur që sot që flasim në ditën e enjte. Vijnë 1 numër shumë herë më i vogël qytetarësh. Për shkak të investimeve që ka mundur të bëjë bashkia me të ardhurat e veta, kryesisht edhe normalisht edhe me të ardhurat nga ana e qeverisë. Dhe mendoj që bashkia e Patosit funksionon në 1 farë mënyre dhe në qoftë se 1 gjë funksionon si nga ana financiare dhe nga ana e shërbimeve, pse ta ngacmoh? Ky është parimi për çdo gjë. Faleminderit.

### **Majlinda Bufi:**

Në lidhje me pyetjet tuaja, treguesit e performancës financiare, shërbimet ndaj qytetarëve, delegimit të njësisë, në fakt. Sigurisht që unë mendoj që ky është rast pas rasti te pjesa e administratorit, delegimi i kompetencave. Në fakt, në fakt do thoja që edhe ligji nuk është se e qartëson shumë dhe e ndan shumë mirë këtë gjë. Sigurisht që administratori është ish-kryetari i djeshëm i komunës. Dhe padyshim që është personi edhe më afër qytetarëve. 1 pjesë të përgjegjësive ai ka në lidhje me kontaktet e drejtpërdrejta, marrjen e problematikave, konflikteve. 1 pjesë e procedurave janë të lidhura edhe me konfirmimet që duhet të bëjë administratori për sa i takon ankesave, problematikave, disa aplikimeve që lidhen edhe tek ministria e bujqësisë. Padyshim që ka rolin e vet. Por unë mendoj që deri më tani nuk ka funksionuar ashtu siç duhet. Pjesa e administratorit. Sepse mendoj që edhe kjo pjesa i zgjedhur i emëruar autoriteti kryetar i bashkisë me administratorin e emëruar kanë ato disbalancat e veta. Dhe sjellin këtë lloj performance, po ka të bëjë ndoshta edhe me qasjen rast pas rasti. Ndërkohë që 1 performancë më e mirë do ishte që të ishte me më shumë kompetenca, ndoshta me më shumë funksione të deleguara. Në lidhje me performancën financiare, unë mendoj që nga 1 vit në vitin tjetër ka ndryshuar, ka progres. 1 pjesë e mirë e bashkive në 2. Po ti referohemi 2015-s, padyshim që borxhi total i bashkive diku ishte shumë i lartë, diku më pak, por shumica e bashkive ndoshta ka edhe bashki që si rasti i Patosit, për shembull, që kanë qenë shumë të mira, meqenëse e njoh që jemi në rritje në qark. Por në përgjithësi treguesit financiarë të performancës kanë qenë në rritje pozitivisht. Progres pozitiv. Sot, për shembull, nuk mund të përmendim borxhin që ka qenë në atë kohë. Edhe pse në ndonjë rast edhe mund të vazhdojë akoma, mund të ketë akoma. Por unë mendoj që këto lidhen me 2 fakte, lidhen me 2 faktorë, edhe me mundësitë reale që bashkitë kanë. Për sa u takon burimeve natyrore, burimeve ekonomike që kanë bashkitë për të gjeneruar të ardhura. Ndoshta edhe me mënyrën e menaxhimit që vetë stafet, bashkë me kryetarin e bashkisë, kanë. Për 1 qasje, po themi,

më të drejtë ndaj politikave tarifuese ndaj qytetarëve, ndaj bizneseve, sepse edhe kjo ka rolin e vet në këtë gjë. Por ndoshta, ndoshta unë mendoj që këtu duhet të ishte edhe 1 politikë edhe më e qartë në lidhje me fuqizimin ekonomik të bashkive. Për sa u takon taksave në nivel vendor, në nivel lokal, taksat e biznesit. Këtu ka vend për rregullim. Është 1 moment që duhet ndërhyrë në mënyrë të saktë, të detajuar. Që ato mundësira ekonomike që kanë në territor, bashkitë t'i shohin dhe t'i shfrytëzojnë si resurse. Për t'u fuqizuar ekonomikisht. Ky është 1 moment i rëndësishëm që kjo reformë duhet ta marrim në konsideratë, sepse ne e dimë shumë mirë që 1 bashki pa buxhet nuk ka se çfarë bën. Ashtu pastaj siç vjen edhe ajo forma tjetër pas vlerësimit që qeveria i bën gjithë territorit për sa u takon mundësive dhe burimeve natyrore. Ekuilibrimi. Ose mbështetja me fond për bashki të cilat realisht nuk kanë mundësira. Por kjo vjen pasi qeveria të ketë bërë vlerësimin real dhe të vërtetë në lidhje me mundësitë që ka territori. Unë do thosha 1 gjë të fundit fare që ajo që e sjell gjithë gjënë në përmirësim është qartësimi i kompetencave, qartësimi i funksioneve ligjrisht dhe financiarisht. Këto janë 2 elementë që janë shumë të rëndësishëm.

### **Eriselda Sefa:**

Atëherë, për sa i përket pyetjes së 1-rë, treguesit financiar do të thoja që bashkia e Lushnjës është 1 nga bashkitë me performancën më të mirë financiare në vend. Si për rastin që ne nuk kemi detyrime ndaj të tretëve prej 2-3 viteve të fundit, por ndërkohë kemi edhe 1 dyfishim të të ardhurave. Kjo gjë na ka bërë që ne të rrisim nivelin e shërbimeve ndaj qytetarëve tanë si në qytet dhe në çdo zonë rurale, por patjetër edhe të kemi mundësi të bëjmë edhe investime të cilat t'i vijjnë akoma në ndihmë këtyre qytetarëve. Për sa i përket shërbimeve, shërbimi i pastrimit, nëse do ta merrja si shembull në zonat rurale, para reformës nuk ekzistonte. Sot i gjithë territori i bashkisë së Lushnjës merr shërbimin e pastrimit. 1 pjesë e zonave rurale sot kanë edhe shërbimin e ndriçimit publik. Më parë, shumica e fshatrave nuk njihnin as çakullin në rrugët e tyre, ndërkohë që sot të gjithë fshatrat me rrugët e tyre kryesore janë të asfaltuara dhe ne vitet e fundit kemi filluar të ndërhyjmë edhe në lagjet e fshatrave, në mënyrë që të përmirësojmë infrastrukturën e tyre. Patjetër që me buxhetin e bashkisë kemi ndërhyrë edhe në objektet shëndetësore dhe arsimore, në mënyrë që t'i përmirësojmë akoma këto shërbime për qytetarët tanë. Ndërsa për sa i përket delegimit të funksioneve, njësitë administrative në territorin e bashkisë performojnë në mënyra të ndryshme. Unë i kam deleguar 1 pjesë të funksioneve ashtu siç e ka parashikuar ligji, ashtu siç është ajo marrja e 1 deklaratë për kryerje punimesh, shërbimet sociale, apo në rastin duke qenë 1 bashki bujqësore, ne kemi shpesh edhe shumë konflikte për çështjet e pronave. Këto kërkesa dhe këto ankesa fillimisht shqyrtohen në njësitë administrative dhe në rastet kur njësitë administrative nuk arrijnë dot t'i japin zgjidhjen e duhur, atëherë këto problematika kalojnë në bashkinë qendër, në mënyrë që ajo t'i shqyrtojë rast pas rasti.

### **Luçiano Boçi:**

Po. Zoti Baci, fjalë për ju.

### **Luan Baçi:**

Faleminderit, zoti bashkëkryetar. Të nderuar kryetarë të bashkive të qarkut të tjerë. Lejoni ta nis me 1 koment të vogël fjalën time. Unë do t'ju. Jo këshilloja, se është në tag-ët tim, por do t'ju ftoja që diskutimet tuaja, komentet tuaja të ishin jo si kryetarë të partive socialiste, të Partisë Socialiste, por si kryetarë bashkisë. Për arsye se kur bëhesh kryetar bashkie, pavarësisht se kujt force politike i përket, në pikën atë karrike je kryetar për të gjithë komunitetin dhe për të gjithë banorët. Dhe në këtë drejtim mendoj se madje edhe pyetjet që ne bëjmë, unë do të thosha që do të mjaftonte vetëm përgjigjja e njërit nga kryetarët e bashkive, se janë përgjigje pothuajse standarde të njëjta dhe nuk lëvizin asnjë gjë dhe është 1 kohë e humbur. Plus, më lejoni të shtoj që në dëgjesën që patëm në Thier, pas daljes nga dëgjesa, shefja juaj e madhe, siç e quani, në 1 deklaratë që bëri për mediat, tha që harta elektorale e Thierit është shumë në rregull. Nuk ka asnjë lloj problemi dhe asgjë nuk ndryshon. Dhe unë mendoj që ju jeni të gjithë të dakordësuar me shafen tuaj që asgjë nuk ndryshon në Thier. Dhe këto dëgjesa duket sikur janë pak fallco. Ndërsa për ju, zonja Bufi, më vjen keq, por më duhet të them që duhet të kishte kursyer ndërhyrjet për kërkesën time që të ishte kryetar i bashkisë së Thierit, sepse është në të drejtën time që ta kërkoj se është kryetar i bashkisë me qendër qarku. Tani mos më ndërprisni. Dhe. Dhe. Të paktën ju nuk duhet të ndërhyni. Ju jeni në konflikt interesi me mua, jeni në gjyq. Kështu që ruajeni këtë për në gjyq aty në Thier, se gjyqin e 1-rë e humbët në gjithë kohë për shpifje dhe për thyerje. Tani jeni, tani jeni, tani jeni në 1 gjyq tjetër që kërkonte 5 milion lekë shpërbim se jeni prekur nga emocionet. Shiko, unë di të jap përgjigje kujtdo të jeni të bindur, kështu që kur nuk ju drejtohem, mos më drejtoni, do t'ju lutesja. Kështu që do të ishte mirë dhe unë nuk do të merrem fare me juve, për shembull, të pyes për Bashkinë e Roskovecit. Për arsye të konfliktit që kemi, sa të mbarojmë edhe atë gjyqin dhe pastaj bisedojmë ose kemi komente, por unë asgjë s'bëj, unë thjesht vetëm pres. Të nderuar kryetarë të bashkive, pyetjet i kam edhe të përgjithshme, po ndoshta ndonjëherë edhe të përveçme sipas bashkive. Për qarkun Thier, 1 nga problematikat më të rëndësishme që të gjithë e dimë është menaxhimi i mbetjeve urbane. Unë do të doja të dija si veprohet sot, aktualisht në menaxhimin e mbetjeve urbane, çfarë problematikash kemi dhe sipas mendimit tuaj, ndërtimi i inceneratorit të Thierit ishte 1 gjetje? Ishte e duhura? S'kini detyrimin që të thoni se funksionon apo jo, prandaj kërkoja praninë e kryetarit të bashkisë së Thierit, sepse është ai autori kryesor i ndërtimit të inceneratorit të Thierit. Këmbëngulësi kryesor, madje dhe menaxhuesi kryesor, por me sa di sot të gjitha bashkitë kanë 1 farë përqendrimi të menaxhimit të mbetjeve urbane. Si zgjidhet ky problem dhe a ka problematika në territorin e bashkive tuaja? Kam parasysht rastet e bashkisë së Lushnjës që ka pasur dhe protesta. Besoj për bllokimin e disa zonave të mbetjeve urbane disa kohë më parë. Dhe për bashkitë e tjera, po kështu. A mendoni se bashkitë e vogla kanë të ardhura që kanë të ardhura të ulëta? Duhet të kenë status të veçantë? Apo menaxhohen në këto situata siç janë? Në bashkitë tuaja. Në të gjitha kuptimet, domethënë, po pra, po pra, në të gjitha kuptimet. Në bashkitë tuaja, sidomos në bashkitë e mëdha, mendoni se ka zona që janë shumë larg vendimmarrjes nga qendra dhe nuk arrin shërbimi ashtu siç duhet dhe në kohën e duhur? Po njësitë vendore. Funksionojnë me kompetenca të mjaftueshme, do t'i quaja, për shërbim ndaj qytetarëve të vetë, banorëve që ata mbulojnë? Juve e quajtët në fjalën tuaj reformën e 2015-s, 1 reformë të suksesshme, pothuajse të gjithë, por në fakt lindi nevoja për të bërë 1 ribërje reforme, si ta quajmë, ose 1 reformë të

re. Mendoni se brenda 10 vjetësh vlen të bëhet 1 reformë tjetër kur reforma quhet e suksesshme? Pse jo, ta them unë, pse jo, se reformat nuk bëhen 1 herë në 5 vjet apo në 10 vjet, por reformat bëhen që të jenë shumë, shumë vjeçare, të qëndrueshme kur janë studiuar. Meqë e doje përgjigjen kryetarit të bashkisë së Lijakës. E kam 1 pyetje për të 5 juve kryetarët e bashkive. Vërtet e mendoni se kur 1 deputet, por qoftë edhe 1 qytetar i thjeshtë, por unë flas për 1 deputet me status deputet, bën 1 kërkesë institucioneve që ju drejtoni dhe ju kërkon numrin e punonjësve të bashkisë? Thjesht emër, mbiemër dhe pozicion pune, jo numër telefoni, jo kartë identiteti, jo përbërje familjare. Mundet që kjo të quhet shkelje e të dhënave personale? Jo. Lexo. Qerim. Ti ke qenë kryetar i komunës në Kut, sot je kryetar i bashkisë së Malla Kastër. Shiko, unë e kam konfidenciale se e njoh shpejt Qerimin. Gjithsesi, zoti kryetar i bashkisë së Malla Kastër. Ju pëlqeu zoti deputet? Po. Aranitasi. Ka shkollë. Dhe para disa kohësh ka qenë 1 iniciativë e banorëve të Aranitasit për të rregulluar, për rehabilituar pjesën e jashtme të shkollës me iniciativën e tyre dhe me fondet e tyre. Po. Në fakt, është e vërtetë. Në fakt, është e vërtetë. Kjo do të thotë që është shumë larg qendrës së bashkisë së Malla Kastës. E pra, e pra, e pra, e pra, e pra, e pra, e pra, e plevist, ti do kesh vajt vonë aty. E po pra, unë kam qenë shumë herë aty. Drenovë është pak, pak larg Ballçit. Si është rruga e Drenovës? Ti mund të dalësh. E njëjta gjë në Drizar. Po, shumë emigrantë dhe banorë janë bashkuar aty, madje kanë investuar. Po, po, po, po, është informacion shumë i saktë dhe i plotë. Dhe pastaj e keni ndërhyrë. Kjo tregon që e keni lënë pak pas dore të gjithë zonat dhe 1 pyetje: a e dini që me statistika fshatrat e Malla Kastës dhe Malla Kastrë janë më të populluara në përqindjet e larta në gjithë vendin? Arsyeja pse ka ardhur. Mos ju thënde për Greqicën që ke 1 kilometër rrugë, janë 40 familje. Dhe madje po ta hapni në rrjete sociale, është 1 banor i Greqicës që ka marrë makinën dhe e ka hedhur, ka mbushur me gurë bagazhin që të kalojë, se nuk kalonte dot. Në qoftë se Dhivjaka ketë 1 propozim të bashkohet me Lushnjën, të bëhet 1 bashki, çfarë mendimi keni? Qerim. Dhe për juve 1 pyetje tjetër: si do të preferonit më mirë, Malla Kastrë të bashkohet me Thierin apo të krijohet 1 bashki fratar se lidh Greqicë e Kalkut? Këto kisha unë. Ju faleminderit për vëmendjen.

### **Luçiano Boçi:**

Po, në qoftë se i ka mbaruar, po, deputeti, patjetër që po. Po, Ismail, fjala për ju.

### **Qerim Ismailaj:**

Atëherë unë besoj që për të do t'ju jap përgjigje të gjitha pyetjeve. Po, do t'ju jap përgjigje të gjitha pyetjeve, por unë besoj që këtu nuk është çështja 1 gjëje konkrete, por qëllimi është efekti që duhet të ketë reforma. A duhet bërë reforma, si duhet bërë reforma, okej. Por në qoftë se do ndalemi te shembujt konkretë, jam plotësisht i gatshëm për të gjitha shembujt për këto dhe shumë shembuj të tjerë. Besoj fatmirësisht pjesën ndërmuese të këtyre i njoh dhe personalisht mbi e sigurtë kjo mbi 90% jo vetëm të këtyre këtu, por edhe ata që janë emigrim. I di problematikat shumë mirë dhe pyetja e 1-rë lidhet me menaxhimin e mbetjeve. Bashkia Malla Kastër ka 1 funksionim, ka 1 landfill. Vetë ne aktualisht jemi duke u punuar me Agjencinë Kombëtare të Mbetjeve, i 1 proces i cili ka kaluar në dijeninë time për të gjitha bashkitë e Republikës së Shqipërisë do të ketë të përqendruar dhe të

gjithë kompetencat dhe gjithçka tjetër do të trajtohen nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Mbetjeve. Natyrisht, qytetarët dhe pjesën teknike të cilën unë nuk mundem të se ku duan, por ajo çfarë është në çdo bashki do ndërtohet, aq çfarë di unë është që në çdo bashki do ndërtohet qendër transferimi, ashtu siç ka Thieri, dhe bashkia do të kenë detyrën thjesht për t'i çuar të gjitha mbetjet dhe të bëjë ndarjen e tyre në 1 qendër transferimi. Dhe aty pastaj Agjencia Kombëtare e Mbetjeve do të merret me transferimin e tyre në vendet e caktuara për të gjithë rajonet e Shqipërisë. Pyetja e 2-të që u bë ishte: a duhet të ketë status të veçantë për bashkitë e vogla?

**Luçiano Boçi:**

Falë Zotit Ismail, 1 pyetje: buxheti nga do të dali për transferimin, vetëm për transferuar, do e paguani ju?

**Qerim Ismailaj:**

Aktualisht, sot buxheti, buxheti i transferimit përballohet nga qeverisja qendrore. Të gjitha bashkitë kanë 1 transfer nga Ministria e Linjës për të gjithë kostot e transportit të mbetjeve. Kjo është pa përjashtim për të gjitha bashkitë, sepse ne kemi tabelat e buxhetit. Po besoj edhe deputetët për me hartuar buxhetin. Tani, normalisht nuk mund të them shifër të saktë, mos gabofsha se duhet të jem shumë i saktë te shifra, mos gabofsha. Për bashkinë Mallakastër është diku te 18 milionë lekë, mos gaboj. Duhet. Urdhëro.

Është në total, nuk është për tonë, është për total sepse ka bashki të ndryshme, kanë lartësi të ndryshme nga qendrat përkatëse që do të jetë, por me ligjin e ri, me funksionimin e ri, ajo çfarë unë di është që bashkitë e kanë përgjegjësinë grumbullimi brenda territorit të tyre dhe te qendrat e depozitimit që do të jetë brenda territorit të bashkisë, dhe gjithë pjesa tjetër pastaj do të merret me do të merret Agjencia Kombëtare e Mbetjeve për transferimet e të gjithëve. Natyrisht kjo kërkon një trajtim teknik që kërkon ekspertë që ndanë, nuk jam për këtë gjë, ky është informacioni që kjo është pjesë. Gjithsesi, në rast se, në rast se, të lutem, në rast se kjo lidhjet a duhet që kompetenca e mbetjeve të jetë te bashkitë apo jo, unë besoj kjo formulë, për shkak të provoj që ta lidhim pak me reformën territoriale dhe me kompetencat që duhet të kenë bashkitë, unë besoj që pjesa e trajtimit të mbetjeve nga ana e bashkive, qeverisë vendore, brenda territorit të vetë, me grumbullimin në gjithë territorin e vetë dhe me ngritjen e qendrës së transferimit dhe pastaj transferimi në agjensi të specializuara siç do të jetë Agjencia Kombëtare e Mbetjeve, për mua personalisht është zgjidhja më e mirë e mundshme. Lidhur me pyetjen e dytë, a duhet të kenë status të veçantë bashkitë e vogla? Në gjykimin tim, në rast se ne do të kemi, jam plotësisht dakord me të gjithë ato që tha kolegja e Eros Kovecit, lidhur me dy nivelet e pushtetit vendor, niveli i parë bashki dhe niveli i dytë qarqet apo rajonet në çdo lloj formati që do të jetë, me kompetenca të qarta dhe të ndara, do të isha totalisht kundër që të kemi diferencim brenda bashkive, që të ketë bashki nivelit A dhe bashki të nivelit B, sepse kjo do të krijonte paqartësi, jo thjesht në mënyrën e funksionit, sepse kjo rregullohet me ligj, por do të shkaktonte një pabarazi në shërbimin ndaj qytetarëve, sepse një bashki e cila do të kishte kompetenca më shumë, patjetër që do të ofronte më shumë. Lidhur me trajtimin financiar pastaj të bashkive, natyrisht e transfertat e pakushtëzuar, te formula e

transferit të pakushtëzuar aty ka një diferencim, ka një formulë përkatëse në mënyrën se si ndahet financimi i bashkive, sepse ka bashki të cilat i kanë të ardhurat minimale dhe pjesën më të madhe të tyre mbulohen nga qeverisja qendrore. Lartësia nga qendra në periferi, besoj që u dha përgjigje dhe në komentin e parë, unë besoj që të lidhur me shërbimet po flasim nga bashkia qendër Qarku me periferinë, në qoftë se marrim Malakasrën, Malakasra ka një territor 330 km<sup>2</sup>, lartësi, fshati më i largët që është, është fshati Shorrush, që është 30 km larg, por gjithsesi ai nuk e ka pasur një sërë shërbimesh përpara me ish-komunat, po sot shërbimi i pastrimit edhe në këtë fshat, pavarësisht lartësisë, dhe kur flasim shërbimi i pastrimit Zura 1, që mos të keqkuptohemi, shërbimi në infrastrukturën arsimore, shëndetësore, shërbimi, ajo që është shumë e rëndësishme për zonat rurale, që do të dalë pak, që lidhet pak edhe me pyetjet e tjera, në infrastrukturën rrugore, natyrisht që është shumë më i përmirësuar sesa në ish-komuna. Në qoftë se duhet të a duhet të ketë reformë të re kur 2015 a është një sukses? Unë jam i bindur që ajo reformë ishte një sukses, por natyrisht që çdo kohë ka sfidat e veta, ndryshojnë dhe evoluojnë gjërat dhe patjetër një rishikim i kësaj reforme dhe një nga të cilat ka nevojë, besoj, u përmend edhe nga kolegët këtu, është përputhja e realizacionit, harmonia e kompetencave, të ndarjes së kompetencave midis bashkive, qarqeve dhe qeverisë qendrore, që është një pjesë patjetër që duhet parë, sepse ligjet për 10 vjet dhe gjithçka tjetër ka evoluar dhe këtu edhe pjesa e trajtimit të kompetencave ligjore, njëra për shembull është kompetenca e ujit të pijshëm, e cila ka qenë një reformë, në shembullin tim personal, një nga reformat më të suksesshme, sepse në rast se marrim bashkinë Malakasër, mund të jap edhe shembull teknik këtu te kjo pjesë, ka 13 stacione pompimi dhe vetëm pagesa e kostos së energjisë elektrike nuk arrinte ta përballonte me të ardhurat që realizohej, sepse është terren i tillë dhe ka nevojë. Sistemi i ndërtuar ndër vite dhe ky nuk është një proces që mund të ndërtohet për një vit apo për dy, mund të ndërtohet me një investim apo me dy, po kërkon një vendimmarrje shumë më të gjerë dhe shumë më të tillë dhe fatmirësisht është investuar duke qenë kjo e përqendruar në 51 përqind që i ka aksione Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës nëpërmjet AKKUM-it, Agjencisë Kombëtare të Ujësjellësve dhe të Mbetjeve. Besoj që është një reformë, të paktën për rastin e bashkisë Malakasër, shumë pozitive. Lidhur me listën e punonjësve dhe me emrat e tyre, mbase kjo ka nevojë për një konsultë juridike që të jemi më specifikë në këtë pjesë, por besoj që çdo bashki e ka në faqet e veta të UEB-it dhe gjithë pjesën tjetër e ka të pasqyruar. Numrin e punonjësve dhe për secilën drejtori dhe për secilin sektor, pastaj dhe ndërmarrjet, varësi ose njësi administrative, çështje të emrave, natyrisht duhet mbase një konsultë juridike në kuptimin me mbrojtjen e të dhënave personale, është apo s'është e tillë. Tani të kalojmë pak, sepse janë pyetjet konkrete, në anita sa ka shkuar dhe a ka pasur ndërhyrje dhe kërkesë nga. Po pra, do ta shpjegoj, po pra, do ta shpjegoj, do ta shpjegoj, do ta shpjegoj. Aranita si është 6 kilometra nga dera e bashkisë. Dhe ka një shkollë 9-vjeçare, ka dhe shkolla të varëse, ka ndërhyrë bashkia me ndërmarrje shërbime publike, nuk ka pasur të paktën për 7 vjet, por besoj dhe përpara dhe para 7 vjetësh me gjithë reformën që të jemi të sinqertë, nuk ka pasur investime nga komunitetet e banorëve, por gjithë kohën është mirëmbajtur nga bashkia. Ndryshimi ka qenë kjo. Një sekondë, të lutem, jam kthej po të them, jam i bindur që nuk ka pasur në asnjë rast ose në bashki nuk është paraqitur në asnjë rast vetëm asnjë kërkesë e tillë nga banorët për të investuar në

shkollën e Aranitas, por kanë ndërmarrë shërbime publike, sepse kam qenë vetë prezent, e kam ndjekur vetë edhe pjesën e ndërhyrjes për mirëmbajtjen dhe rregullimet që ka pasur, ka ndërhyrë ndërmarrja e shërbimeve publike të bashkisë Malakasër. Në dijeninë time nuk ka asnjë rast që të ketë ndërhyrje nga banorët për rikonstruksionin e kësaj rruge dhe shkolle. Gjithsesi, në çdo rast jemi të hapur, sepse jemi në zonë, mund ta verifikojmë shumë lehtësisht edhe me edhe konkretisht me banorët. Si është rruga e fshatit Drenovë? Atëherë fshati Drenovë është një nga fshatrat më të mëdhenj të bashkisë Malakasër, janë 3 Drenova në ndarjen e fshatrave Drenova, Fushë Drenovë, Qendër Drenovë e Re. Drenova Fushë dhe Drenovë Qendër ka qenë një investim i kryer që herët, ndërsa Drenova e Re nuk ka pasur rrugë të asfaltuar, është një segment prej mos gaboj 2.7 kilometrash, rrugë i investuar nga të ardhurat e bashkisë Malakasër dhe është rrugë e rikonstruktuar. Ajo çfarë ju i referoni, pra fshatrat në linjën e tyre i kanë rrugën e shtruar, të asfaltuar, jo thjesht të shtruar, por kjo diskutohet një rrugë që duhet një rrugë. Ajo çfarë vesh kërkesë është në rastin konkret një rrugë që lidh dy fshatrat, por që vetë fshatrat me zonën urbane janë të lidhura, janë të lidhura me njëra-tjetrën. Ndërsa në qoftë se thuhet për rrugën e Drizarit, edhe rruga e Drizarit është një rrugë e shtruar dhe kjo me të ardhurat e bashkisë Malakasër. Atje ka pasur një iniciativë në bashkëpunim dhe është një metodë të cilën ne e kemi stimuluar bashkëpunimin midis banorëve dhe vetë bashkisë me ndërmarrje shërbime publike për të bërë rregullimet në qendrat. Sepse është krijuar një traditë për organizimin e festave të fshatit dhe bashkia kontribuon vetë dhe ka biznesmenë të zonës të cilët kanë shfaqur interes të kontribuojnë për qendrat e fshatit të tyre dhe kjo lidhet edhe me qendrat, por edhe kjo është bashkëpunim midis bashkisë dhe komunitetit të atij fshati. Lidhur me Greshicën, Greshica është një fshat në Malakasër që për shkak të rrugës është shumë e njohur, besoj nga të gjithë, rrugës së vjetër nacionale, kalonte nëpër atë fshat. Ka një territor jashtëzakonisht të gjerë, të shpërndarë dhe në Greshicë nuk ishte asnjë ndërhyrje deri në vitin 2001. Greshica është bërë 5 kilometra rrugë, mos gaboj, tek shifra e gjatësisë së rrugës, por dua ta konfirmoj saktësisht që është investuar nga bashkia Malakasër dhe ky është një segment rrugor i investuar totalisht nga bashkia Malakasër. Kemi ndërhyrë në shumë segmente të lagjeve. Rruga konkrete e cilës i referohet është një media, me devijim këtej se nuk është as media ajo, është një i ashtuquajtur portal individual, nuk është as gazetari, asgjë. Është thjesht Guardia e Shtëpive, është një skenë e realizuar dhe punon, edhe ai që e ka hedhur e njej shumë mirë dhe e kam kontaktuar për të trajtuar problematikën. Është një rrugë që para dy vjetësh kemi ndërhyrë me mjetet e bashkisë Mallakasër, rehabilitimin e plotë të saj për shkak të mosmirëmbajtjes ose më saktë dëmtimit të një fermeri që kishte punuar atje, ndodhi për shkak të shirave që ranë para dy, mos gaboj, një muaji, pati një dëmtim atje dhe realizoi një skenë të tillë. Por gjithsesi ajo çfarë është e rëndësishme që në rrugë rurale, në këtë mënyrë organizimi i bashkive është shumë më e mirë. Pyetja e fundit lidhet si duhet të jetë Malakasa. Natyrisht Malakasa është një krahinë etnike, kulturore e veçantë edhe gjeografike. Në nivelin gjeografik ka një shtrirje shumë të madhe sesa fillon nga kodra e Pojanit dhe mbaron në Lufti të Tepelenës. Fillon nga mali i Plashtikut dhe në lumin Vjosa në krahun tjetër. Aktualisht sot ka 330 kilometra katrorë. Natyrisht lëvizja e popullsisë dhe demografia është një proces që ka ndodhur në të gjitha dhe besoj unë me aq njohje sa kam, nuk është vetëm fenomen shqiptar, por është edhe pjesë e zonave rurale të vendeve të tjera fqinje.

Dhe këtu kam parasysh edhe Greqinë në rastin konkret, por pyetja ishte drejtpërdrejt: a do të ishte ti të bashkohesh me Fierin apo të ndahesh dhe njësi afëratarë mbeten? Mendimi im besoj që Malakasra duhet të ngelet bashki më vete, një e tërë në formatin që është aktual. Në rast se do të gjykohet që brenda kësaj të shtohen zonat e tjera malakasiothe, patjetër, por kurrsesi një ndarje në Malakasë e fratarë dhe këtë e them dhe si një vetë banor i zonës së njësisë administrative që përfshin fratarë se Elitë e Kutë që është një zonë në të cilën unë kam edhe banoj dhe vetë. Por për arsyet mund të zgjasin pafund ekonomike, potenciale njerëzore dhe gjithçka tjetër, unë besoj që funksionimi më i mirë është funksionimi aktual dhe bashkia Malakasër duhet të ngelet në formatin aktual. Faleminderit. Në qoftë se ka diçka të paqartë Luan.

### **Luçiano Boçi:**

Po. Po. Po atëherë dikush tjetër ka ka përgjigje? Zoti Baçi koment që jo, atëherë kush e do fjalën? Zoti Jahaj.

### **Klevis Jahaj:**

Shumë faleminderit bashkëkryetar. Dhe realisht dua të falenderoj edhe kolegun Baçi për shqetësimet që ngriti për zonën e Malakasër. E kam të miqësore këtë, shpresoj që të ma pranosh ftesën që të shkojmë bashkë në Malakasër, se besoj ke disa kohë pa shkuar dhe janë zgjidhur një pjesë të tyre problematikave. Të shohësh edhe rrugën që ka përfunduar e Malakasrës nga përsa i takon segmentit të Malakasrës, gjithsesi. Në fakt unë kam dy pyetje, se pjesa më e madhe besoj që është rasti i parë që marrim komente dhe pyetje shumë të qarta nga kryetarët e bashkive dhe doja t'ju përgëzoja edhe për nivelin e përgjigjes, por gjithashtu edhe për punën që keni bërë deri tani. Dhe ajo që doja më shumë edhe si koment është pikërisht për të sqaruar dy koncepte bazë që kanë të bëjnë me mirëadministrimin dhe me funksionet që ka bashkia. Është tjetër koncept mirëadministrimi dhe patjetër që atë e vlerësojnë qytetarët kur shkojnë në zgjedhje dhe të gjitha me radhë, dhe është tjetër koncept dhe kush është qëllimi i kësaj reformës territoriale, pikërisht për të ndarë në qoftë se funksionet aktuale ose ndarjet aktuale të pushtetit lokal e arrin qëllimi për t'i shërbyer më mirë qytetarëve. Dhe besoj që ne nuk mund të biem pre as ne të mazhorancës, po aq më shumë edhe ju të opozitës pre e komenteve ose kërkesës së llogarisë kur bëjmë pyetje në lidhje me këtë proces, sepse qëllimi jonë bazë është që çfarë mund të përmirësojmë nga ky komision i posaçëm dhe mund t'i vijmë në ndihmë administratorëve të pushtetit lokal për t'i shërbyer më mirë qytetarëve. Pastaj qytetarët vetë e ndajnë me votë si e kam ndarë dhe deri tani, në qoftë se punët ose mirëadministrimi i kompetencave të dhëna është në lartësinë e duhur. Dhe në fakt këtu mjafton t'i referohemi se u përmend shpesh për rritjen e numrit të punonjësve. Unë kam një statistikë në krahasuar me 2014-ën, me 2025-ën, vetëm punonjësit e aparatit të bashkisë të qarkut të Fierit ka qenë nga 1844 është ulur në 967. Aparat administrativ. Dhe ndërkohë pagat për këta punonjës janë rritur me 10 përqind në nivel vjetor, gjë që tregon sepse mirëadministrimi, rritja e të ardhurave patjetër është reflektuar jo vetëm në reduktimin e numrit të administratës, por gjithashtu dhe në rritjen e pagave të tyre. Unë dua t'ju bëj një pyetje dhe mund të përgjigjet kushdo nga ju, sepse kam shumë kuriozitet, gjithmonë

ngrihet ky problematika që po i largohemi qytetarëve me shërbime, ky reforma dështoi sepse u larguam nga qytetarët. A mund të shtuani një kuriozitet? Ore kush ka qenë ky shërbim që jepet nga komuna dhe nuk jepet tani dot nga JKA në një shërbim të tillë që është larguar? Një, e para. E dyta. Sipas mendimit tuaj, cilat janë ato kompetenca të bashkive apo shërbime që mendoni se bashkitë e kanë më të vështirë të realizojnë dhe a lidhen këto me burimet financiare, ndarjen e kompetencave apo organizimin territorial? Pyetja tjetër është. Dhe besoj që këtu edhe ju do keni mundësi që të thoni se qëllimi i kësaj diference ndërmjet reformës së parë dhe organizimit territorial, ndarjes territoriale dhe mëparshme. Dhe qëllimi i reformës 2015 ishte pikërisht forcimi i bashkive dhe bërja e bashkive më të forta financiarisht dhe nga kompetencat e burimeve njerëzore, kapacitetet e burimeve njerëzore që ato kanë. Sipas mendimit tuaj dhe eksperiencës që keni, a ka ndikuar forcimi i bashkive në rritjen e aftësive për të thithur më shumë investime dhe aplikimin për projekte që kanë dhe për implementimin e këtyre investimeve strategjike që mund të jenë në zonat dhe bashkinë tuaj? Dhe në qoftë se ju mund të përmendni ndonjë konkret. Gjithashtu, dhe pyetja e fundit është në këndvështrimin tuaj, a mendoni se duhet kjo reformë duhet t'i fokusohet në ndryshimin e hartës apo tek forcimi i bashkëpunimit ndërvendor, decentralizimi financiar dhe rritja e kapaciteteve administrative që duhet të ketë pushteti lokal? Shumë faleminderit.

**Arbjan Mazniku:**

Faleminderit. Po, zonja e Bufit.

**Majlinda Bufi:**

Secili prej kryetarëve. Shumë faleminderit për pyetjet që në fakt janë shumë të rëndësishme dhe lidhen drejtpërsëdrejti edhe me eficiencën e kësaj reforme. Edhe me nevojën se pse duhet një rishikim apo një reformë e re. Që janë bashkitë më të forta, kjo nuk diskutohet fare. Sepse ka mjaft tregues sot të cilët tregojnë në mënyrë zyrtare me të dhëna që bashkitë sot janë shumë më ndryshe nga ç'kanë qenë. Edhe në drejtim të zbatimit të funksionimit, të mbledhjes së të ardhurave, të rritjes së buxhetit, të burimeve njerëzore në përgjithësi. Pa dyshim. Që ne kemi sot buxhete më të shtuara. Ashtu siç unë do thoja që paralelisht me këto të dhëna pozitive me progresin që janë bërë, ka vend për diskutime, ka rast pas rasti momente ku gjërat duhen qartësuar, sigurisht që po. Ju përmendët këtu një element dhe thatë në cilat kompetenca bashkitë nuk e gjejnë veten ose nuk janë të aftë për të marrë një. Po marrim shërbimin e ujitjes dhe të kullimit. Është një kompetencë e transferuar në vitin 2015 kur u bë reforma para 10 vitesh. Ka qenë plotësisht kompetencë e Ministrisë së Bujqësisë e bordeve në atë kohë dhe si pasojë e reformës kompetenca iu transferua bashkive. Me një, po themi, shoqëri financiare jo plotësisht të mbuluar dhe këtu është momenti i parë që ky e duhet shqyrtuar. Është përmendur dhe ngritur edhe nga ne si kryetarë bashkie herë pas here si një moment që duhet parë, por kjo reformë dhe kjo kohë me të cilën ne me këtë funksion zbatuan qëndruam pranë fermerëve kudo që ata janë për t'u dhënë atyre shërbimin e ujitjes dhe të kullimit me pastrimin e kanaleve ka vend për rishikim. Sepse edhe kjo kompetencë është e ndarë midis bordeve të kullimit dhe bashkive. Por ama kjo tregoi që kjo lloj mënyre

përsëri nuk e jep 100 përqind efektin te fermerët, sepse kanalet e treta, për shembull, është një ngërç që ka ngelur. Sipas ligjit ai duhet ta zgjidhin fermerët. Por a zgjidhet të jepet ky shërbim nga fermerët? Jo, nuk jepet, sepse një pjesë e mirë e fermerëve, për shembull, s'janë fare të interesuar të merren me tokën. E kanë tokën nga 7500 ishi, s'merren me tokën, nuk u intereson fare kanali i 3-të. Një pjesë tjetër janë në emigrim. Pra, këto arsye. Këto problematika të konstatuara sjellin që ky moment duhet riparë. Tjetër, nuk mundet që bashkia 100 përqind ta zbatojë vetë këtë lloj funksioni. Sepse kanalet e mëdhaja, kanalet e larta. Kërkojnë mjete edhe më të mira, më të sofistikuara për t'i zgjidhur, për t'i pastruar këto kanale. Pra, ky është një moment që duhet riparë, duhet qartësuar kompetenca. Të vijmë te pjesa e zjarrfikësve. Edhe kjo është një kompetencë e cila u transferua në vitin 2015 sipas reformës drejt bashkive dhe kjo periudhë e zbatimit tregoi që po, pati progres deri diku. Dhe bashkitë filluan të fuqizuan këtë lloj shërbimi, krijuan stafet e veta. Disa bashki blejnë vetë mjete me mundësitë që kishin, disa të tjera i morën si donacion. Sot ende ka nevojë bashkitë që të përmirësojnë përsëri flotën e mjeteve të tyre, por ama kjo periudhë e zbatimit tregoi që këtu ka nevojë përsëri për t'u riparë. A ndoshta është më mirë që kjo të mblidhet në bazë rajoni? Momente të caktuara kanë treguar që kur ky lloj funksioni menaxhohet nga qarku, bëhet edhe më mirë, jepet edhe më mirë te qytetarët. Pra, raste si këto tregojnë që në momente të caktuara dhe në shërbime të caktuara ka nevojë për rishikim. Por kjo nuk do të thotë që çfarë është arritur deri tani është më keq nga ç'ka qenë. Sigurisht që është më mirë nga ç'ka qenë. Të vijmë edhe te pjesa financiare. Buxhetet tona ka bashki. Unë po marr referojmë Rrëzkoveci. Rrëzkoveci ka qenë një bashki që s'arrinte dot të mblidhte, jo, jo të rriste buxhetin e vet në masë më të lartë se ajo që merren nga qeveria, por nuk arrinte dot të rriste edhe nivelin e mbledhjes nga 30 përqind. E kanë gjetur nivelin e mbledhjes së ardhurave dhe sot jo vetëm që ka kaluar mbi 80 përqind, por buxheti i krijuar nga ne përmes të ardhurave është më i lartë nga ajo që marrim ne nga qeveria. Padyshim që ka dhe bashki të tjera këtu prezent në qarkun e Fierit, por dhe bashki në qarqet e tjera dhe kjo tregoi që kjo reformë në një farë mënyre i ka dhënë këtë efekt bashkitë. Padyshim që janë forcuar edhe më shumë financiarisht, por ende nuk kanë arritur aty ku duhet, sepse ka nevojë edhe për qartësim, po themi, të taksave të ndara, taksave kombëtare. Ato që u përmendën edhe më parë. Në mënyrë që bashkitë të jenë edhe më të pavarura dhe të kenë më shumë mundësira për të rritur buxhetet e tyre. Dhe ky është momenti kur kjo reformë përsëri tregon që këtu ka nevojë për të ulur dhe për ta parë dhe për ta përmirësuar këtë gjë. Por ne nuk mund të themi. Kurrsesi që shërbimet që jepeshin në komuna më përpara sot nuk jepen nga bashkia. Përkundrazi, janë të shtuara. Të gjitha shërbimet që sot jepen në bashki, le të themi pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi. Pastrimi i kanaleve, kurrsesi nuk jepeshin në disa prej komunave të mëparshme, edhe për shkak jo vetëm të, po themi. Mënyrës se si menaxhoheshin, po themi nga ana njerëzore në atë kohë, por edhe për shkak të mundësive financiare. Kishte komuna të cilat nuk arrinin dot që të paguanin pagat e punonjësve në atë kohë e jo më të kishin mundësira që të bënin edhe investime dhe të jepnin shërbimet e qytetarëve. Sigurisht që këto janë shumë më ndryshe, shumë më të rritura në kuptimin cilësor. Dhe të vijmë tek pjesa tjetër. U përmend këtu, e përmendët edhe ju, u përmend edhe këtu nga parafolësit. Që jashtë shtuar pjesa e përqindjes në buxhetin total të bashkisë kundrejt pagave. Sigurisht që dështohet, sepse ka shërbime të

shtuara. Ka shërbime të shtuara të cilat padyshim kërkojnë dhe punonjës. Ne nuk i jepnim më përpara asnjë lloj shërbimi social. Sot japim shërbime sociale. Kemi qendra komunitare, shërbimin ndaj të rinjve, ndaj grave të dhunuara, shërbime të tjera. Këto shërbime nuk jepen në ajër, jepen me njerëz të cilët janë punësuar pranë bashkive dhe automatikisht kërkojnë edhe paga. Kemi funksionet e deleguara, të cilat padyshim që marrin edhe shoqërohen me një pagesë nga qeveria, por hyn te kjo pjesë e përqindjes që zë në buxhetin total të bashkive. Të gjitha këto janë argumenta që tregojnë që shërbimet janë të shtuara. Dhe padyshim edhe pjesa e pagesave dështon. Sigurisht që po. Ajo që ne diskutojmë sot është ta shohim gjithë gjënë në këndvështrimin pozitiv, si ta përmirësojmë gjënë, si ta rrisim dhe ajo që thatë ju që duam të bëjmë një reformë për ndryshim harte. Apo diçka tjetër? Sigurisht që qëllimi nuk është ndryshimi i hartës. Qëllimi është qartësimi i kompetencave. Ndryshimi i gjithë gjësë në mënyrë që bashkitë të krijojnë më shumë pavarësi. Që desentralizimi si proces të kryhet i plotë. Por nëse raste konkrete pas një vlerësimi real që i bëhet zonave të caktuara, që ndoshta mund të jenë edhe të mëdhaja në territor, kërkojnë realisht që aty ndoshta duhet bërë diçka për të qenë më pranë qytetarëve. Pse jo? Pra, rasti edhe mund ta sjellë një gjë tjetër, por nuk duhet të jetë qëllim në vetvete një ndarje e re e hartës. Territoriale. Unë mendoj që kjo reformë sot duhet të ketë këtë qëllim të gjithë së bashku të qartësojmë ca kompetenca.

#### **Luçiano Boçi:**

Zonja Bufi, zotëria ka konflikt interesi me mua. Jo, jo, jo, nuk është çështje konflikti interesi.

#### **Majlinda Bufi:**

Pra, ajo që unë dua të them në përmbyllje e kuptohet. Qëllimi e kuptohet. Qëllimi nuk është një ndarje harte e re. Faleminderit. Qëllimi është kompetenca të qarta, të shoqëruara me financa korrekte për çdo shërbim dhe funksion.

#### **Luçiano Boçi:**

Vetëm një pyetje kam: a keni marrë ju në të gjithë ne apo ne juve? Së dy së bashku, a jemi për një qëllim këtu? Se s'po e kuptoj këtë gjë unë, megjithatë. Po, tani ka një problem në mënyrën se si i parashtroni ju gjërat këtu. Ju tha pak zoti Jahaj që nuk jemi këtu për të treguar sa mirë apo sa keq keni administruar ju pushtetin në bashki. Për ju po e thoni për mua individualisht dhe ju flas për të gjithë ju, për të gjithë ju. Nuk e kam personalisht me ju, sepse më shumë se u lavdërua Malla Kastra, nuk jeni lavdëruar ju në raport. Kështu që ke një konkurrencë të fortë brendshme aty. Midis jush e keni këtë gjë dhe çështja kryesore është që pse duhet kjo reformë? Se unë nga parashtrimet e juaja që me të drejtë luani i quajti edhe leksione. Ne s'po e kuptojmë në qoftë se gjithçka që e ka tek harmonizimi ligjor i qartësimit të kompetencave i funksionalitetit nuk ka nevojë fare për reformë. S'ka nevojë, s'ka pse jemi ne, e bën qeveria dhe ju e dini shumë mirë këtë. Dhe deputetët e maxhorancës e dinë shumë mirë, madje e kanë përsëritur dhe po e përsëris zonja Bufi dhe duhet të jeni në dijeni. Qeveria ka një plan strategjik ndërsektorial për pushtetin vendor dhe qëllimi kryesor, një ndër pikat është harmonizimi ligjor për të qartësuar kompetencat. Dhe funksionalitetin dhe nuk ka nevojë fare, është detyrë e

qeverisë dhe nga ana strukturore. Unë të falenderoj që ti je në një linjë me qëndrimin e PD-së për qarqet, se e dëgjova tek parashtrësia e parë. Falenderoj shumë për këtë, sepse dhe PD-ja këtë do me qëllim që mos biem në kurthin që është bashki e vogël, nuk i bën të gjitha, nuk i realizon të gjitha kompetencat. Hajde ta mbyllim, jo, është qarku ai që mund të marrë kompetenca përbashkëta themelore dhe t'i koordinojë planifikimin e territorit, menaxhimin e mbetjeve që Malla Kastër ishte shumë e lumtur që kompetencën ia kishte marrë qeveria, ujërat, se edhe Malla Kastër ishte shumë, shumë e lumtur që ia kishte marrë qeveria kompetencat, se sa thonë duam kompetenca brenda jush, sa nuk dashken kompetenca. Pra, dhe për këtë pjesën e qarkut unë falenderoj shumë. Por ama, ama duhet të jemi shumë të qartë. Reformë është një ndryshim rrënjësor. Reformën nuk e kemi kërkuar ne, zonja Bufi. Nuk e kemi kërkuar as ju, ç'është e vërteta? Ju jeni shumë të lumtur, unë e shoh mirë këtu, mirë te rrugët, mirë tek shërbimet. Ju jeni shumë mirë edhe ndonjëherë unë ju flisni, unë them: "Po e po, pse qeveria, pse Edi Rama ka marrë përsipër të vëmë punë në parlamentin, të harxhojmë dhe ca lekë nga parlamenti, të bëjmë sikur po bëjmë reformë?" Po ju qekët shumë mirë dhe kaq të lumtur sa s'kemi nevojë fare, por ama ka nevojë për një reformë dhe reforma. E di kush është thelbi? E ulëret qytetari, e kërkon ai, ai po vërtet, sepse nuk ka marrëdhënien e duhur me shtetin. Ky është thelbi i problemit, nuk është mirë administrimi, i keq administrimi. Këtë e ndan gjykata, nuk e ndajmë ne se si është administruar dhe opinioni, po s'e ndajmë ne këtë këtu politikisht. Ne mund të themi vërejtje, ju mund të thoni lavdërime dhe përplasemi me njëri-tjetrin dhe nuk duhet një hartë. Po më duhen të gjitha kompetencat, funksionaliteti, por të gjitha këto lidhen me territorin, sepse qytetari do të shërbehet një, kërkon, përfaqësohet dhe zbatohen ato parime që janë europiane. Një territor ka identitet, ka identitete të forta këtu. Rrëzkoveci, jam dakord unë, ka identitete, është e pamundur për mua që ta bashkosh me Fierin, as nuk e çoj nëpër mend ju, ose kam domethënë dua të të marr me të mirë apo Patozin. Edhe Patozi nuk mund të bashkohet me Malla Kastrën, për shembull, apo me dikë tjetër. Kanë identitetet e tyre të forta dhe këto duhen ruajtur. Por ama në fund fare jemi te funksionaliteti i territorit. Në qoftë se qytetari është larg shumë dhe nuk e merr shërbimin. Në qoftë se janë mbyllur Malla Kastër, 29 shkolla është ndez alarmi i kuq. Në qoftë se Malla Kastër është depopulluar në 41 përqind, është nga bashkitë më të depopulluara, shpopulluara, atëherë këtu gjithçka është në alarm. Është marrëdhënia e shtetit me qytetarin. Ka ikur qytetari, nuk e ndjen shtetin tek dera e tij, atë shërbimin e ndriçimit, e pastrimit, e gjelbërimit që paguan taksa, tarifa, nuk e ndjen ai, nuk e merr. Nuk do të thotë që mori 10 kilometra rrugë në 12 vite dhe gjithçka u krye, se para 10 viteve kishte marrë 14 kilometra. Gjithë e gjithë Malla Kastër nuk mjaftojnë as ato 14, as këto 10, jo, duhet akoma më shumë dhe thelbi i territorit të çon patjetër në një riorganizim territori, se duhet ta çojmë shërbimin afër qytetarit. Dhe të gjitha shërbimet dhe duhet krahas kësaj, duhet edhe paketa financiare shumë të qarta, sepse mua më bën habi zonja Sefa ngriti çështjen e kompetencave, e falenderoj, mua më bën habi që asnjë prej jush nuk ngre zërin për çështjet e autonomisë financiare, sepse e di pse ju kemi thirrë qartazi, jo t'ju nxjerrim keq para votuesit, fare. Nuk e kemi qëllimin, ne jemi opozita politikisht, dimë ta bëjmë në formate tjera, me deklarata, me fakte, me denoncime. Sot jemi dhe ju kemi ftuar për t'ju thënë: "Ju jeni këtu, çfarë problemesh keni dhe çfarë doni nga komisioni jonë që ne t'i reflektojmë?" Ju thoni: "Unë kam bërë 10 kilometra, unë kam bërë këtë," por në rregull,

vazhdoni atëherë, e mbyllim. S'që ka e domosdoshme reforma, se në gjë juve, në gjë kryetarët e tjerë, asnjë nuk e ngre zërin, asnjë jemi shumë mirë me qeveri, rroftë qeveria. Ne duam, zonja Bufi, që këtu të vini me kërkesa. Ne duam kompetencat 1, 2, 3 për këto kompetenca që nuk janë të shoqëruara me para. Duam para nga buxheti i shtetit, më taksat janë ato, tonat janë, qytetarëve tuaj janë. Ku i gjeti shteti nga xhepi i vet? I ka, jo më taksat e Malla Kastër, Lushnjës dhe Patosit, Fierit, këto janë taksat. Të vijë në një formë tjetër, të vijë si grant, i guxuar, i paguxuar, të vijë në formë financimesh të ndryshëm, po t'i ketë bashkia dhe të ketë autonomi t'i përdori sipas nevojave dhe kërkesës. Pra, mos kemi qasje tjetër, se ndryshoi komplet dëgjesa në një përplasje performancë. Se ju keni dëshirën, instiktin politik që paraqisni një gjënë e mirë, patjetër që ju doni të bëni akoma më mirë se ç'keni bërë, nuk e vë në dyshim unë. Por pyetja ime është e thjeshtë, shumë retorike: i keni duart e lidhura apo i keni të zgjidhura? Dhe shqetësimi ynë si opozitë është që ju i keni të lidhura. Edhe prej lartësisë, prej shpopullimit, se jeni mbi 20 përqind, përveç Fierit që është 15 përqind. Qarku më i shpopulluar, që unë nuk e mendoja që të ishte Fieri, se ka pasur një lloj trendi zhvillimi ekonomik, është ndër qarqet më të shpopulluara. Ka humbur 70 mijë nga 2011-a, sipas censusit, 70 mijë banorë. Të gjitha ju, gjithë bashkitë e juaja janë mbi 20, 22 e sipër, dhe ky është treguesi i marrëdhënies. Se unë e kam edhe me shaka, nuk e kam vetëm kështu me ironi. Po dëgjoja zotin Ismailaj, e thashë: "Po zhvendosem, po iki në Malla Kastër, po iki nga Elbasani, se atje qeka kaq bukur."

#### **Majlinda Bufi:**

Mos u zhvendos në Malla Kastër, po hajde në Rrëzkoveci. Kisha hall se duke vazhduar më tej do e bëja kërkesën live, se kjo ju e bëni, mund ta bësh edhe kështu, domethënë ndryshimin. Në qoftë se më lejon, zoti bashkëkryetar, dhe njëherë, zonja Bufi, se shumë shkurt, jo vetëm një minutë, vetëm një minutë.

#### **Luçiano Boçi:**

Kemi arritur, kemi arritur, meqenëse kemi arritur limitin, edhe në fakt dua të bëj edhe unë një pyetje të thjeshtë. Po s'ka gjë, e kisha se ishte fjala juaj dhe nuk dua të them mua në dijenë që ishëm shumë.

#### **Majlinda Bufi:**

Që të gjithë ato që ne përmendëm kishin brenda edhe dakordësinë, edhe problematikën, edhe progresin, edhe asaj që duhet të përmirësohet. Tani unë nuk e di se si e dëgjoni ju, nuk e di si e kuptoni ju, por në qoftë se ju prisnit që ne këtu të vijmë e të fillojmë e të shajmë qeverinë, kjo nuk është ajo që duhet. Unë mendoj, unë mendoj që ne këtu duhet të flasim siç është realiteti dhe ne këtu përmendëm gjithë realitetin mbi bazën e asaj që funksionon dhe asaj që nuk funksionon. Megjithatë, ju jeni bashkëkryetar i opozitës, do thoni fjalën tuaj, pa dyshim keni qëllimin tuaj, por ky është realiteti. Kjo reformë ka dhënë efektet pozitive dhe ashtu siç ka dhënë efektet pozitive, ka edhe mangësitë të cilat duhen përmirësuar.

#### **Luçiano Boçi:**

Atëherë, në qoftë se do ishte përmirësim, thashë nuk do kishim komision reforme. Reforma është evidentim i një problemi të thellë dhe përpjekje për ta rregulluar këtë problem. Kjo është fjala reformë. Mos bëjmë tani kot parashtrime që s'kanë kuptim. Përmirësimet i kishte bërë vetë qeveria dhe e kishte kryer punën. Fjala për zonjën Agjill.

**Brunilda Haxhiu:**

Përsëritet, të nderuar kolegë deputetë, të nderuar kryetarë të bashkive të qarkut Fier. Më duket sikur jemi vërtet midis dy realiteteve të ndryshme, ajo që flisni ju dhe ajo që ne dëgjojmë nga banorët kur shkojmë tek ata. Kemi qenë dëshmitarë të shumë fshatrave të përbytur në sezonin e dimrit. 3 herë janë përbytur fshatrat në qarkun Fier dhe e dimë shumë mirë që ka pasur mosmirëmbajtje të kanaleve të kullimit, po ashtu e dimë shumë mirë që tokat bujqësore thahen në verë, pra përbyten. Në dimër dhe thahen në verë, pra është një falimentim total i bujqësisë në qarkun Fier dhe mosmbështetje e tyre. Sigurisht që mund të ketë fonde dhe mund të ketë grante, por këto nuk shkojnë tek banorët, thjesht këto nuk shkojnë tek fermerët. Ju lutem, të mbaroj unë, pastaj mund të ndërhysh. Po, pra, çështja është. Mund të ndërprisni.

**Edmond Haxhinasto:**

ju lutem, deputet bashkëkryetar. Nuk mund të pres të ndërprisni deputetët.

**Luçiano Boçi:**

Po merresha tani i zotit që na dhanë edhe për çfarë duhet të bëjë reforma, si duhet ta bëjë. I dëgjuam të gjithë leksionet me shumë respekt, tani të ketë respekt dhe të dëgjojnë deputetët. Po, patëm dhe një debat paraprak që nuk ishte midis meje dhe zonjës Bufi, posaçërisht ishte për të gjithë ju. Jemi në Kuvendin e Shqipërisë, Komisioni i Reformës Territoriale, prevalojnë sigurisht në fjalën e tyre dhe respektohen deputetët, sikurse dhe të ftuarit. Secili ka: "Jo, nuk mund ta marrësh, se s'po jua jap." Patjetër, jo e ka deputetja fjalën. Kur të keni të drejtën e fjalës, pasi të mbarojë deputetja, do e merrni dhe do jepni përgjigjen tuaj. Shumë e thjeshtë.

**Brunilda Haxhiu:**

Patjetër që janë zhvilluar dhe dëgjesa publike me fermerët, por këto janë dëgjesa publike që nuk zhvillohen me të gjithë, por ata seleksionohen. Prandaj ndoshta ju vjen dhe hidhur kur dëgjoni këto fakte. Kemi qenë po ashtu dëshmitarë të banorëve që kanë dalë në protestë dhe kërkojnë rrugë prej vitesh, kërkojnë rrugë dhe ato nuk bëhen. Kërkojnë qendra shëndetësore, pra, dhe këto më së tepërmi kërkojnë në zonat rurale. Çfarë tregon kjo? Tregon që prioritet i është dhënë zonave urbane me këtë reformë territoriale. Janë përqendruar fondet dhe shërbimet në qytete dhe janë lënë në harresë zonat rurale. Janë lënë në harresë fshatarët, fermerët. Edhe zonat urbane, të cilat duket sikur i është dhënë prioritet, në fakt është investuar në fasadë, është investuar në pedonale dhe jo në shërbime funksionale që rrisin cilësinë e jetesës së qytetarëve. Kemi një centralizim të kompetencave dhe të fondeve në duart e qeverisë, sidomos pastaj në duart e bashkisë e bashkive të mëdha. Është për t'u vënë re fakti, sigurisht, që kryetari i bashkisë më të

madhe të qarkut, kryetari i bashkisë së Fierit, sot mungon. Në fakt, është pikërisht kryetari që merr më shumë fonde dhe që duhet të jepte më shumë llogari sot në këtë takim. Unë pikërisht, unë pikërisht kam për të trajtuar dhe çështjen e zhvendosjes së gjendjes civile të njësisë administrative "Cakra", e cila shkon në Levan, dhe zoti Qerim Ismailaj, që është edhe kryetar i bashkisë Malla Kastër, besoj se është dhe më i ndjeshëm ndaj kësaj zone, duke qenë se e ka dhe pranë, dhe duhet ta dini shumë mirë që background-i i tyre historik-kulturor nuk shkon me zonën e Levanit, sepse historikisht kanë pasur marrëdhënie me Malla Kastrën. Unë mendoj që për hir të numrit të banorëve që atje ka, 17 mijë banorë, ndoshta më shumë, dhe 13 fshatra, një potencial ekonomik dhe shkolla, qendra shëndetësore, pra, i ka të gjitha kapacitetet, plotëson kriteret për të qenë dhe bashki më vete, dhe është një kërkesë e vazhdueshme e këtyre banorëve. Bashki, pra, atë që u takon këtyre banorëve me të drejtë, ndërkohë që kemi një tallje të tyre, merret gjendja civile e "Cakranit" dhe çohet në Levan, që nuk i lidh as rruga, as pozicioni gjeografik, as historia, as kultura. Pra, çfarë është kjo? Por ama kemi një fakt që këta banorë kanë ngelur pa zë në këshillin bashkiak, kanë ngelur pa zë te kryetari i bashkisë, sepse kryetarët e njësisë administrative nuk zgjidhen nga banorët, por emërohen nga kryetarët e bashkive. Atëherë, si mundet ky kryetar i njësisë administrative të ngrejë zërin për banorët? Në fakt, qëndron në linjë me kryetarin e bashkisë ose me urdhërat që i jepen kryetarit. Pra, humbet, humbet zëri i këtyre banorëve. Tjetër, kemi rastin e paketës së maleve, e cila është një dëshmi e qartë e centralizimit të pushtetit. Qarku Fier nuk ka male, por si në të gjithë Shqipërinë, po aplikohet me urdhër të Edi Ramës në kodra dhe sipërfaqe bregdetare. Atëherë, pyetja është: sa dëgjesa publike janë kryer me banorët, jo me administratorët dhe stafet e zgjedhur nga ju? Si shpjegohet që toka bujqësore prodhuese kthehet në panele, në resorte turistike dhe braktiset bujqësia? A nuk nxit kjo shpopullimin përfundimtar? Pse nuk kemi një hartë të zonave prioritare, kriteret e projekteve që përfitojnë dhe publikim të emrave? Kam hapur faqen e bashkisë Fier, për shembull, dhe atje vetëm jepet si lajm që po bëhet ky projekt, por asnjë informacion se në çfarë hapa jemi konkretisht. Nëse paketa e maleve rezulton në betonizim të zonave rurale dhe humbje të tokës bujqësore, kush do të mbajë përgjegjësi politike dhe institucionale për pasojat? Pra, a kemi këtu një imponim të qeverisë për paketën e maleve, apo kemi një vullnet të lirë të kryetarëve të bashkisë për ta realizuar atë në interes të qytetarëve? Pyetje tjetër: a ka sot zona administrative që ndihen të papërfaqësuar ose të larguar nga qendra e vendimmarrjes pas reformës? A mendoni se njësitë administrative kanë kompetenca dhe burime të mjaftueshme? Faleminderit.

### **Arbjan Mazniku:**

Faleminderit. Vetëm një koment të shkurtër kam përpara sesa të jepni përgjigjen. Do mundohem që ta ndajmë. Jo, jo, vetëm një koment të shkurtër kam unë. Së pari, për deputetin e nderuar që na bashkohet, së pari, shumë faleminderit për prezencën. Është shumë e rëndësishme t'ju shpjegoj që kryetarët e bashkive nuk janë këtu për të dhënë llogari. Kryetarët e bashkive i japin llogari përpara kryetarëve që kanë votuar. Sa prej tyre kanë marrë në emrin e tyre më shumë vota se jo pak njerëz janë në këtë sallë dhe vijnë këtu për t'u dëgjuar, jo për të dhënë llogari. Kështu që thjesht për të qenë të qartë dhe për

t'i treguar kryetarëve të bashkive si institucione autonome kushtetuese respektin që meritojnë, vijne këtu për t'u dëgjuar. Faleminderit.

**Josif Gorrea:**

Nëse mundem, faleminderit meqë ndihesha i ndërhyrë më herët, patjetër nuk ishte mirë, por e nderuar deputete Agjill, mendoj sikurse e tha edhe bashkëkryetari, ne këtu kemi ardhur për reformën territoriale dhe jo për të bërë politikë. Dhe dëgjova fjalën tuaj, nuk pashë shumë pyetje, por pashë shumë politikë. E para, e para, e para, e para, do ju përgjigjem dhe ju,

**Arbjan Mazniku:**

Zoti Baçi. Ju lutem, zoti Baçi, në kohën tani, në kohën e përgjigjes, në kohën e përgjigjes do ja lemë ta gjykojë ai si do t'ia japë përgjigjen.

**Josif Gorrea:**

Po, patjetër që përmbytjet e mëdha, patjetër që përmbytjet e mëdha... Ti nuk gjykon pyetjet, gjykon dhe përgjigjet. Pyet, patjetër pra. Zoti Baçi, unë kam nderin, e di, ti e di që je i përzgjedhur dhe nga bashkia Divjak si deputet, kështu që mos... Kështu që duhet të kesh pak respekt për kryetarin e bashkisë që të ka zgjedhur si anëtar parlamenti. Ata pra bashkia ato, ata njerëzit aty. Po, pra, po. Ishim tek përmbytjet dhe dua t'ju theksoj edhe bujqësia. Do të ndalem vetëm tek ajo pjesë. Pjesën tjetër do të ndalen kolegët e mi. Ju lutem, te kjo pjesë dua t'ju sqaroj se reshet e shiut këtij viti ishin më të mëdha në 30 vitet e fundit, nëse nuk e dini. E dyta, patjetër që në reshet e mëdha do të ketë edhe problematika dhe patjetër gjithmonë ka problematika pafundme, por unë po të marr bashkinë ku unë drejtoj, që jemi... Unë lagem nga dy lumenj të më të tmerrshëm që zbresin nga malet sipër. Shkumbini nga njëra anë dhe semëni nga ana tjetër. Dhe patjetër që patëm tek këtu përmbytje të vogla. Patëm dhe rreziqe, por i përballuam me sukses shumë të mirë. Kështu që që ta kalojmë në politikë, nuk është e mirë. Pastrimi i kanaleve ka vijuar me përpikmëri. Bordi i Kullimit, në bashkëpunim me bashkitë, e gjitha qarkut është në funksion të përditshëm në bashkërendim të gjërave. Patjetër, deti na theu edhe bankinat dhe ne ishim atje. I keni parë dhe videot, ose hidhuni shikojeni. Pra, kjo ishte çështja e bujqësisë. Bujqësia patjetër ka problematikat e veta që duhen përmirësuar dhe qeveria shqiptare, dhe qeveria shqiptare këtë vit me paketën e re mbështetëse është në nivelet më të papara. Ka dy elementë të jashtëzakonshëm. 10% e faturës kur dorëzon, automatikisht kalon. Nëse nuk e dini. E dyta, e dyta historike në të gjithë, në të gjithë Europën. Qeveria shqiptare mbështet 70% të mbrojtjes biologjike. Është një nga paketat më të mira në të tërë Europën, pra që fermeri jonë të prodhojë pa mbetje. Në mënyrë që prodhimet tona t'i hamë vetë shumë të mira, por dhe t'i eksportojmë kudo. Pjesët e tjera i ndaj me kolegët. Faleminderit.

**Arbjan Mazniku:**

Përpara se t'ia jap fjalën zonjës Sefa, t'i kërkoj zotit Duro, duhet të largohet për një gjë urgjente, ndaj dhe ndaj kërkon ndjesë, po thjesht t'i japim mundësi lëvizjeje. Zonja Sefa.

## **Eriselda Sefa:**

Atëherë doja t'i bëja një përgjigje zonjës deputete. Nëse përmirësimi i shërbimit ndaj qytetarit lidhet vetëm me territorin, mendoj që kjo gjë është e gabuar, sepse ne këtu jemi bashki të mëdha, por patjetër kemi dhe bashki të vogla. Por ajo që ne duhet të mendojmë në kuadër të kësaj reforme është si të përmirësojmë që t'i shërbejmë akoma më shumë qytetarëve dhe si ta bëjmë pushtetin vendor që të jetë më shumë funksional. Patjetër që në këto 10 vite të reformës janë përmirësuar shumë shërbimet e qytetarëve. Ka nevojë të përmirësohen, patjetër këtë gjë e pranojmë dhe ne. Ne sot kemi një shërbim të ujitjes dhe kullimit, dhe këtë gjë po e lidh me bujqësinë që në bashkinë e Lushnjës shumë herë më i mirë, sepse sot vërtet këtë vit pati një përmbytje. Kjo ishte si rezultat i lumenjve, por jo se nuk funksiononin kanalet kulluese. Sot në 80% të territorit funksionojnë kanalet ujëse. Kjo ka bërë që shumë fermerë t'i kthehen bujqësisë dhe jo kot bashkia e Lushnjës sot është një nga potencialet më të mëdha ekonomike për bujqësinë në rang vendi dhe sidomos në fushën e perimeve. Kemi nevojë të përmirësojmë dhe të investojmë akoma më shumë këtë gjë. Patjetër dhe këtë gjë e pranojmë dhe ne. Prandaj themi që kemi nevojë akoma më shumë për mbështetje financiare, në mënyrë që qytetarëve tanë t'i shërbejmë në të gjithë territorin, jo vetëm në qytet që përmendët ju, por patjetër të shkojmë edhe në skajin më të largët të fshatrave, sepse të gjithë qytetarët i kemi të barabartë. Për sa i përket dëgjesa publike, të gjithë dëgjesa publike njoftohen dhe bëhen nga këshilli bashkiak, sepse shumica e dëgjesa bëhen para vendimmarrjes së këshillit bashkiak dhe është kompetencë dhe detyrë e tyre, dhe të gjitha shpallen në faqet tona zyrtare publike. Të gjithë qytetarët janë të mirëpritur të majtë dhe të djathtë, sepse ne mbi të gjitha jemi kryetarët e qytetarëve tanë. Nuk i shohim ata në bindjet politike. Kjo gjë mund të bëhet në periudhën zgjedhore, por më pas i kemi qytetarët tanë. Dhe sa për informacion, nëse do të shikoje faqen e bashkisë së Lushnjës, do të shohësh që në dëgjessën e buxhetit ke përfaqësues të këshillit bashkiak nga PD-ja. Tek dëgjesa së fundmi që kemi pasur për paketën e maleve, kemi pasur përfaqësues nga PD-ja, që do të thotë që këto dëgjesa janë shumë të hapura për të gjithë qytetarët tanë dhe patjetër që ne duam që ata ta marrin këtë informacion dhe të bëhen pjesë jo vetëm e vendimmarrjes dhe prioriteteve që ne vendosim për investimet përkatëse, por patjetër pse jo të jenë edhe përfitues në paketën e maleve.

## **Luçiano Boçi:**

Zonja Sefa, falenderoj për sinqeritetin e lartë kur përcaktuat që ne qytetarët i shohim si të majtë apo të djathtë vetëm fushatat zgjedhore, se në fakt është shumë e vërtetë. Madje dhe investimet kështu i shihni sipas zonave të majta, të djathta, ndonjë ndërhyrje domosdoshme, dhe kjo është gjëja më e gabuar që ju na e pohuat në një formë shumë të thjeshtë, por që unë e kam ngritur vazhdimisht në dëgjessa. Një nga arsyt kryesore që pushteti vendor nuk funksionon mirë është mbulimi i plotë politik që i vjen nga qendra. Pushteti lokal është magazina e votave të pushtetit të qendror, dhe unë e di shumë mirë tensionin që pëson bashkia sapo hyn në fushatë zgjedhore. Shndërrohet menjëherë në shtat politik, gjë që nuk duhet të ndodhi, dhe gjithë angazhimet janë të fokusuara pikërisht tek marrja e votës. I shkon qytetari, gjendet ai, domethënë se ku është 50 kilometra larg

e gjen bashkia, se ia ka adresën me ato mënyrat e veta dhe është e gatshme t'i ulet në gjunjë vetëm e vetëm që ai të reflektojë votën pro pushtetit. Dhe kjo është nga gjërat më të këqija që i ka ndodhur pushtetit lokal që duhet hequr, që kryetari i bashkisë të jetë autonom. Kur flasim për autonominë e pushtetit vendor, autonomia duhet të vijë pikërisht nga vetë brenda forcës politike që e ka zgjedhur dhe është bërë shkak parësor i zgjedhjes së tij. Ta le kryetarin e bashkisë vërtetë në atë shërbimin edhe brenda fushatës zgjedhore për qytetarin, pa diferencuar fare atë. Prandaj vijmë këto shtrembërime, por ne e nënkuptojmë këtë. Të gjithë e dimë, ne mos u lodh fare, i dimë listat si bëhen, si vijmë, si sillet administrata. I kam provuar vetë se kam qenë kandidat, kështu që asnjë shtesë ke kjo pjesë. E di si reflektonte në politikë qendrore dhe në politikë lokale anasjelltas, por shumë mirë që parashtrohet këtu që të gjejmë një formë për ta shkëputur, dhe duhet të jetë një nga objektivat kryesorë të reformës. Prandaj duhet reformë e thellë. Nuk po bëj pyetje fare, e kisha mendim, e kisha mendim, s'kam pyetje. Kur të bëj pyetjet, kam dy pyetje gjithsej. Në qoftë se na del koha pas zotit Haxhinasto, do t'i bëj. Në qoftë se na del koha, sigurisht. Një sqarim të lidhur me caktimin, në rast se bëri pyetje, në rast se ndjesë, në qoftë se mundem. Po. Kurdo?

### **Eriselda Sefa:**

Diçka me zotin Boçi, kur përmenda fushatën elektorale, kisha fjalën që jemi përfaqësues të një force politike, por jo se ne nuk i shërbejmë qytetarëve duke i parë sipas bindjeve politike që ata kanë. Kështu që mjafton të shohësh dhe ato që i përmenda zonjës dëgjessa, dhe do të shikoni që edhe përfaqësuesit e forcës tuaj politike vijmë dhe bëhen pjesë e vendimmarrjeve për të vendosur prioritetet se si i shërbejnë më mirë qytetarëve tanë.

### **Qerim Ismailaj:**

Atëherë lidhur një sqarim, mbase një lapsus. Cakrani dikur ka qenë pjesë e Malakasës, janë Malakasa si rotë. Malakasa sot ka 42 fshatra në pjesë të territorit vetë administrativ, por si Malakasa ka 72, midis tyre bën pjesë edhe Cakrani, por sot është me bashkinë, është me bashkinë Fier, dhe patjetër që nuk është vetëm Cakrani, janë disa, jo vetëm zonat e Cakranit, por edhe disa fshatra të tjerë të cilët janë bashkisë së Fier. Kjo ishte sa për saktësinë, nëse mund të drejtohet si kryetari i bashkisë. Okej, okej, okej, ndihmë thjesht për nuk e kam për debat, duhet ishte thjesht një konstatim. Ndërsa lidhur me paketën e maleve, është një ligj i cili në fund të fundit ka një efekt asaj që këtu prognozohet, ose më falni për shprehjen që thuhet, thjesht. Problem. Paketa e maleve është një, mendoj unë, një stimul që njerëzit të kthehen të investojnë në fshat, sepse investimet në zona rurale janë të mirëpritura, sepse janë këto pikërisht këto investime të pritura dhe të shumëpritura në zona rurale, të cilat do të japin mundësi më tej jo vetëm të punësimit të njerëzve, por për të pasur edhe një jetë pastaj sociale, kulturore, më tej arsimore më të plotë. Dhe besoj që lidhur me dëgjessat publike, çdo qytetar, e tha dhe kolegja e Lushnjës, çdo qytetar në dëgjessat publike di gjë shumë të qartë. Lidhur me dëgjessat publike janë të afishuara, janë pjesëtarë të gjithë dhe çdo ditë vjen përsëritje, por askush nuk përjashtohet nga dëgjessat publike dhe askush nuk përjashtohet nga

aplikimet lidhur me paketën e maleve, lidhur me zonat prioritare, dhe ato janë të afishuara, dalin, janë publike, janë në proces, duke vazhduar, dhe patjetër që zonat prioritare janë miratuar në bazë të kërkesave që kanë bërë qytetarët në banim aktual në Malakasë ose Malakasën, ose në emigrim, dhe të gjitha zonat të cilat kanë pasur aplikime, patjetër që janë futur si zona prioritare për të zhvilluar. Natyrisht ka një proces ligjor, do ndjeki hapat e vet ligjor deri në përfundim të atij procesi.

### **Luçiano Boçi:**

Po, faleminderit. Atëherë zoti Agjinaspo, fjala për ju.

### **Edmond Haxhinasto:**

Faleminderit, faleminderit edhe ju përfaqësuesve të bashkive. Unë kam disa pyetje, në fakt, që ndoshta fokusohen kryesisht tek funksionet e pushtetit vendor. Unë kuptova nga shpjegimet tuaja që qarku Fier ka një bashkëjetesë të shkëlqyer të bashkive të mëdha. Pastaj i takon territorit dhe mundësisë me bashkitë që janë më të vogla. Këtë më lart e kuptoj. Deri sa jeni për të njëjtin format, për të ruajtur të njëjtin format. Dhe unë do të doja të pyesja nëse ju vetë mendoni se ka avantazh të jesh bashki e madhe? Dhe çfarë disa avantazhesh ka po të jesh e vogël edhe anasjelltas? Shumë shkurt i njëjtë, në mënyrë telegrafike. Pyetja e dytë është: duke qenë se ju jeni një zonë nga më të industrializuara të vendit dhe nga më të me bujqësi më intensive, a mendoni se koordinimi juaj në shërbim të këtij sektori kaq të rëndësishëm është i mjaftueshëm? Pra, e keni rrugën, mënyrën që funksionet tuaja në funksion të zhvillimit të bujqësisë që realizoni në këtë format që keni, apo duhet që ky shërbim të arrijë në një nivel tjetër të centralizohet ose të decentralizohet? Pyetja tjetër. Përgjigje telegrafike me po me jo, nuk pres këtu leksione. Shumë telegrafike i pres përgjigjen. Pyetja tjetër është: ka të bëjë në fakt me atë që u shpreh këtu si konservator, që u bë mirë që u centralizuan shërbimet si ai i ujësjellësave, por kuptoj edhe shërbimet e tjera. Logjika për ta decentralizuar në 2014-2015 ka qenë që janë shërbime shumë jetike për qytetarët, dhe një drejtues bashkie duhet të jetë përgjegjës edhe për performancën e këtyre shërbimeve jetike: uji, mbetjet. Pyetja lidhet me këtë: ju mendoni se kjo ka të bëjë me ekonominë e shkallës? Pra, duhet centralizim në këto shërbime të rëndësishme, apo ka të bëjë me kapacitetet menaxhuese për këto lloj shërbimesh, pra ujësjellës, mbetjet, transportin? Dhe pyetja e fundit ka të bëjë me: duke qenë se përveç se jeni zonë me bujqësi intensive, jeni edhe zonë e rëndësishme e nxjerrjes së burimeve natyrore. A jeni të kënaqur me rendën që merrni? Me rendën që ju vjen nga industria përkatëse? Duke qenë se zona juaj ka pasur, nuk e ekzagjeroj të them, por shpeshherë ka pasur edhe masakra mjedisore si rezultat i industrisë së nxjerrës atje, me probleme shumë të mëdha për njerëzit, me ndotje shumë të rëndë të mjedisit dhe me shqetësime për popullsinë më të madhe. Ju çfarë mendoni për këtë? Merrni mjaftueshëm rend nga këto aktivitete? Faleminderit.

### **Arbjan Mazniku:**

Pyetja e parë, më pas kryetarët e tjerë që kanë zonë bujqësore.

## **Majlinda Bufi:**

Faleminderit për pyetjet, zotëri deputet. Sigurisht që janë shumë të vlefshme. Lidhen në njëfarë mënyre me funksionimin e bashkisë, pushtetit lokal. Unë do të doja ta nisja nga ajo që ju thatë në fillim: avantazhet dhe disavantazhet për të qenë një bashki e vogël, kështu siç jemi, a më e madhe, apo edhe ndoshta më e vogël nga të tjerat. Unë mendoj që këtu nuk ka një përfundim ideal ose një rezultat ideal i cili të përfaqësojë apo të vlejë për gjithë territorin. Unë mendoj që kjo duhet parë rast pas rasti, por një fakt është: bashkitë e vogla sot, dhe sidomos ato periferike, qoftë edhe unë, Rustoveci, bashki e vogël, bashkia më e vogël në qarkun e Fierit, edhe pse jemi në zemër të Myzeqes, ku ka intensitet banorësh krahasuar me bashki të tjera në veri apo diku tjetër, përsëri ka mungesë burimesh njerëzore. Njerëzit më të specializuar apo më shumë profesionalë, padyshim, nuk rrinë në qytetet e vogla, por përpiqen të shkojnë drejt qendrave, qendrës së Fierit, qendrës së Tiranës. Dhe unë mendoj që bashkitë e vogla nuk i kanë kapacitetet dhe mundësitë për sa u takon burimeve natyrore për t'i mbajtur të gjitha këto kompetenca. Kështu që një ndarje e qartë e kompetencave këtu duhet të bëhet. Ato lloj kompetencash dhe shërbimesh që lidhen drejtpërsëdrejti me qytetarët, me nivelin bazë, siç janë ndihma ekonomike, zgjidhja e konflikteve, marrja e problematikave, ato që lidhen me bujqësinë, kryesisht në bashki që janë bujqësore, siç është edhe Rustoveci, padyshim që duhet të merren me këto. Sigurisht që po. Por nëse a kemi mundësi për të tjerat? Këtu do të thosha që jo, nuk kemi. Edhe pse në njëfarë mënyre ne patëm rritje pagash, është goxha e mirë, dhe sot sektori publik i pushtetit lokal është i krahasueshëm me sektorin privat, bile dhe më mirë ndonjëherë, por përsëri kjo gjë nuk funksionon. Padyshim që bashkia ka rëndësinë e vetë, rolin e vet në dhënien e shërbimeve qytetare, por të shërbimeve bazë. Dhe këtu unë i qëndroj asaj që thashë në fillim për krijimin e një niveli të dytë. Bëra emrin, pavarësisht se zoti bashkëkryetar tha qartë, unë nuk thashë qartë, unë thashë qartë rajon apo çfarëdo lloj emërtimi tjetër. E rëndësishme është të jetë një nivel i dytë, i cili të marrë këto lloj kompetencash për të cilat bashkia në nivelin bazë nuk arrin dot të jetojë, si përmbushësi i mosjohur. Dhe të vijmë pastaj tek pjesa tjetër, një model, çfarë duhet të bëjë bashkia? Unë do të thosha që bashkitë duhet të ndahen sipas tipologjisë. Ka bashki që janë thellësisht rurale, thellësisht bujqësore, ka bashki të tjera që janë bregdetare, që lidhen me turizmin, dhe padyshim ajo që funksionon te njëra nuk funksionon te tjetra. Për shembull, nëse kompetenca që lidhet me bujqësinë, me shërbimin ndaj fermerëve, ekstensionin, ndihma konkrete, aplikimi për fonde do të ishin të fokusuara, të vendosura në bashki, do të ishte një ndihmë shumë e madhe për fermerët, sepse fermerët do ta kishin më të lehtë, e kanë më afër për ta marrë këtë shërbim në bashki. Në qoftë se kjo është një bashki bujqësore, nëse flasim për një bashki tjetër që ka një tipologji tjetër, padyshim aty duhet të vlerësohet një lloj shërbimi tjetër, sepse nuk janë të gjitha bashkitë njëlloj. Dhe kjo periudhë e zbatimit të kësaj reforme e tregoi këtë gjë dhe ju tregoi që ka nevojë për një lloj rishikimi të tillë. Padyshim që ne jemi dhe bashki industriale. Marinza, kush është Marinza? Patos Marinza? 80% e aktivitetit të kompanisë Banker sot ushtrohet në territorin e bashkisë së Rustovecit, dhe përtej asaj që ne kemi bërë vetë si bashki, duke shtuar në mënyrë të dukshme të ardhurën që ne marrim si pasojë e tarifimit të pasurisë që ata përdorin në territorin tonë, dhe kjo ka bërë që ne të rrisim buxhetin tonë. Por unë këtu

kam, po themi, vërejtje. Dhe padyshim sugjeroj që niveli i rendës që bashkitë minerare apo këto të zonës së naftës duhet të marrin më shumë. Sot ne arrijmë të marrim vetëm 5% të të gjithë asaj vlere që prodhohet nga shitja e naftës ose nga prodhimi i naftës në vend, dhe vetëm 5% e kësaj u kalon bashkive, e cila ndahet pastaj në raport me sasinë e prodhuar në çdo territor. Sigurisht që kjo duhet të jetë më e lartë. Padyshim që po, sepse dhe aktiviteti i naftën nxjerrës ose aktiviteti mineral, efektet e veta të drejtpërdrejta i jep aty në territor, në mjedis. Dhe kjo duhet të jetë një ardhur që të jetë për qytetarët, në mënyrë që bashkitë të shohin në mënyrë të qartë, konkrete, se si duhet kthyer kjo e ardhur në investime për ta përmirësuar këtë gjë. Ky është një moment, për shembull, që duhet të rishikohet. Pavarësisht kësaj që marrim ne sot, unë besoj që duhet të rritet përqindja e rendës minerare që i kalon nga pushteti qendror bashkive. Dhe ju përmendët ekonominë e shkallës në lidhje me ujësjellësat, me disa lloj shërbimesh, me furnizimin me ujë të pijshëm, me menaxhimin e mbetjeve. Unë besoj që bashki të vetme nuk e bëjnë dot. Pse? Ka, për shembull, për të marrë furnizimin me ujë të pijshëm, mund të një burim uhor mund t'i shërbejë për disa bashki. Nuk mundet një bashki e vetme ta menaxhojë, qoftë që nga burimi, sistemi i shpërndarjes dhe gjithçka tjetër lidhet me këtë shërbim, ose duhet të jenë grup bashkish që mund të jetë edhe në territorin e bashkisë tjetër, thotë kolegu im. Padyshim që po, por nëse kjo do të ishte e përqendruar, jo e varur nga qeveria, por e ndarë si kompetencë, por me ndikimin e gjithë bashkive së bashku për të krijuar një operator menaxhimi të përbashkët, sigurisht që do të ishte shumë mirë. E njëjta gjë dhe për mbetjet urbane. Padyshim që po, në territor ne duhet të krijojmë një lloj politike dhe një lloj qasje që del përtej, po themi, mundësisë së një bashkie të vetme. Bashkitë janë të ndara në territor dhe sa më mirë të kemi investime që mbulojnë territore edhe më të mëdhaja, ku efektiviteti të jetë më i lartë, padyshim që po, dhe ne do ta kthenim këtë shërbim jo vetëm thjesht në një mbulim shërbimi më të mirë ndaj qytetarëve, por pse jo në një shërbim fitimprurës, duke bërë ndarje në burim, duke arritur që përmes ndarjeve, mbetjeve që ndahen, shitjes së letrës, siç ne e bëjmë sot në territor. Sigurisht që është në sasi të vogël, por ne krijojmë një të ardhur që e fusim në buxhetin e bashkisë për punimin e mbetjeve bimore, përmes një pike kompostimi që ne e kemi, sigurisht me mbështetjen e donatorëve, por ne krijojmë një lloj produkti, fertilizer, i cili përdoret sot nga bashkia dhe për në marrëdhënie me individë fermerë, të cilët kanë një investim më të madh në bujqësi. Këto janë instrumente të cilat e bëjnë këtë shërbim, në qoftë se menaxhohet në mënyrën e mirë, jo vetëm thjesht që t'i japim shërbim cilësor, por dhe të krijojmë fitim prej kësaj gjëje, siç sot e kanë, për shembull, disa modele shumë të mira në vendet evropiane. Pra, unë mendoj që këto janë për t'u parë. Rezultatet e sotme duhen marrë në konsideratë për të bërë planifikim më të mirë dhe një qartësi më të mirë të gjithë këtyre kompetencave. Nuk e di se çfarë kam harruar tjetër. Ndoshta marr shkak këtu edhe nga ajo që përmendi zonja deputete në qarkun e Fierit. Më fal që po kaloj tani tek çështja tjetër, se nuk e mora fjalën që parë. Më vjen keq, por lexova, dëgjova thjesht një fjalim të madh. Shumë. Po të lutem, më lër zë, unë nuk të ndërpreva, më lër ta them. Dëgjova një fjalim shumë politik, shumë të orientuar politikisht. Do ishte ndoshta më mirë që konkretisht, për gjëra që janë konkrete në lidhje me këtë që lidhen këtu, të thoni: "Paketa e maleve s'ka lidhje me reformën territoriale." Për shembull, nuk ka lidhje, për shembull, me reformën territoriale. Është një lloj, po themi, iniciative që ka marrë qeveria për të shfrytëzuar dhe për t'u dhënë

një mundësi atyre personave të cilët përdorin ish-pronarë apo dhe që përdorin një tokë e cila nuk është subjekt i 7001-shit, nuk është subjekt. Pra, nuk u futemi atyre fermerëve, por për t'u dhënë atyre një mundësi që këtë tokë që e kanë, që e përdorin pa krijuar konflikte, të kenë mundësi ta zhvillojnë. Pra, duke të dalim përtej këtyre ekstremiteve politike, sepse këtu jemi për këtë qëllim. Faleminderit.

### **Arbjan Mazniku:**

Po, ka dikush tjetër pyetje-përgjigje për këtë pyetje?

### **Luçiano Boçi:**

Kam unë. Kam unë dy pyetje ose tre, në fakt, pa i shtuar, se dëshira është për të bërë shumë pyetje. Reforma e 2014-s kishte si qëllim rritjen e efikasitetit administrative dhe u përqendrua në dy elementë kryesorë: uljen e numrit të administratës, punonjësve, që ishte 19 mijë në total, dhe përfitimim të 80 milion eurove që do kaloshin në investime. Në realitet, ne sot kemi dyfishim të numrit të punonjësve, apo jo? Qarku i Fierit, për shembull, numëron 4 mijë punonjës sot që flasim dhe ju pretendoni në parashikimet tuaja që u shtuan punonjësit se u shtuan funksionet, ndërkohë që reforma e 2014-s kishte parashikuar dhe funksionet dhe efikasitetin administrative dhe investimet në bazë të këtij korrelacioni, se nuk është piku nga vend tjetër. Dhe në këtë aspekt, si shpjegohet që sot pesha e pagave zë 47% të buxhetit nga 36%? Se ju keni shtuar administratë punonjës dhe ndërkohë ne dëgjojmë që ju nuk keni kapacitete administrative, sepse ka kundërlogjikë këtu: dyfishoni numrin dhe s'keni kapacitete, po pas këtë para për të paguar njerëz kot, se nuk paguani kapacitetet. Se po të nisem, për shembull, nga një dhënë që ka divjaka për të punësuarit, ka vetëm një punonjës për pyjet, një punonjës. Një punonjës, për shembull, për kujdes të pyjorës, ka pyjet zero. Askë aq shumë? Mirë, dakord, s'ka askë aq shumë. Dakord, dakord, kjo është pyetja që lidhet me 47%. Pse është rritur 47%? Mund të thoni që janë rritur pagat e tjerë, e tjerë, por justifikimi juaj ka qenë me rritjen e funksioneve, ndërkohë që ishte tjetër logjikë në reformën e 2014-s dhe kjo logjikë vazhdon, se për shembull, nga një dhënë që unë kërkova këtu, bashkia e Fierit, që sot nuk është, ka shtuar për një vit 70 punonjës. Nuk ka shtuar funksion nga një vit, një vit, nuk është shtuar asnjë funksion, se është që nga 2014-ta dhe po të shohësh rritjet nga viti në vit, kjo ka ndodhur. Pra, nuk u shtuan që në 2014-n funksionet dhe u shtuan këto numër punonjësish, sepse kjo është rritje në përqindje, në vlerë absolute ka një logjikë, por në përqindje s'ka asnjë logjikë. Dhe pyetja tjetër: ju si bashki a keni përcaktuar një standard minimal për të gjitha shërbimet në të gjithë territorin? Një standard minimal, keni mbledhur këshillin e bashkisë dhe përcaktoni standardet minimale, janë shumë të rëndësishme për qytetarët, bashkë me këshilltarët tuaj. Dhe si mendoni ju, shërbimi që ofroni a ndryshon në territor, është i ndryshëm në qendër të bashkisë dhe është i ndryshëm në periferitë të bashkisë, apo është krejt i barabartë? Se i gjithë ky fluks njerëzish në këtë territor paguajnë të njëjtat taksa, tarifa dhe normal duhet të marrin të njëjtat shërbime. Dhe meqenëse gjithçka lidhet me financat, në fund fare duam ta dimë nga ju: a doni financa më shumë, apo jeni kaq lumtur me këto që keni, që keni bërë gjëra kaq të mrekullueshme me këto që keni? Se ç'i doni më shumë, është vetëm pastaj t'i

hidhni kështu nga dritarja makinës për t'i mbledhur njerëzit, se kështu del nga parashtrimet e juaja. Pra, doni mbështetje financiare, apo nuk doni mbështetje financiare? Po, faleminderit.

**Majlinda Bufi:**

Tani, zoti bashkëkryetar, duhet ta themi shprehimisht në terma shumë specifike. Sigurisht që duam financa, padyshim që po. Ke dëgjuar ndonjë kryetar bashkie të thotë që nuk dua më shumë financa? Patjetër që po.

**Luçiano Boçi:**

Po për shërbime kam fjalën, se financat doni ju, e di unë, unë them për shërbimet ndaj qytetarëve, por e di unë patjetër që po.

**Majlinda Bufi:**

Patjetër që po, duam më shumë lekë, patjetër që po, që të pastrojmë edhe kanalet e treta. Pra, në qoftë se ju na jepni kompetencën për pastrimin e kanaleve të treta që deri tani nuk e ka bashkia, sigurisht që duhet të japim edhe lekë për atë, se në qoftë se e shoqëroni këtë kompetencë me financë, patjetër që do të kryhet me një grafik nga kanali i parë te kanali i fundit, në mënyrë më korrekte të mundshme. Por nëse ky lloj, kjo lloj kompetence... Po sigurisht që i kam përmendur, se i kam thënë nga dyert deri tani, po s'ishit këtu ju, ju nuk ishit këtu. Tani e kam thënë shumë qartë për ato...

**Luçiano Boçi:**

Zoti Haxhinasto ka pyetjet e veta, jo i jep përgjigjë të tjerëve për zotin Agjinaso, se ç'kuptim i ka kjo?

**Majlinda Bufi:**

Patjetër, patjetër. Pra, është shumë e qartë dhe e thënë shprehimisht për kompetencat dhe funksionet që delegohen bashkive, duhen të shoqërohen 100% me financa. Aty, në atë rast, kur ka mangësi, kur janë transferuar pjesërisht me financa, duhet të plotësohen, patjetër që po. Sepse kjo na bën ne më të përgjegjshëm për të dhënë shërbime më cilësore ndaj qytetarëve. Të vijmë tek pyetja juaj: a keni të njëjtin shërbim? Shërbimi padyshim që jepet njësoj me të njëjtën qasje, por diferencime aty ku ka nevojë për më shumë shërbime, duhet dhënë më shumë; kur ka një komunitet më të dendur banorësh, padyshim që shërbimi kryhet me një shpejtësi më të madhe, dhe aty ku ka më pak banorë, sigurisht që është më pak, por jo se nuk jepet. Nëse për shembull shërbimi ndaj biznesit në një qendër ku ka 3 biznese, nuk është njëlloj me atë ku ka 30 biznese. Sigurisht që këto bëjnë diferencën, por shërbimi padyshim që jepet me të njëjtin standard. Në lidhje me standardin që ju thoni për dhënien e shërbimit, sigurisht që ne i referohemi ligjit, praktikës ligjore, detyrimit që kemi dhe ndaj ligjit dhe ndaj moralit. Çdo lloj shërbimi, në momentin që miratohet si i tillë dhe shoqërohet me me buxhet nga bashkia, më fal nga këshilli i bashkisë, kur merret vendim i tillë, padyshim që duhet të jepet dhe jepet me të

njëtin standard ndaj gjithë qytetarëve dhe kudo që banojnë ata. Ju përmendët pjesën e pagave. Është e ripërsëritur. Nuk mund të marrësh një të medaljes dhe të bësh vlerësimin vetëm me një të medaljes dhe të harrosh anën tjetër të medaljes. Në qoftë se ne themi kemi shtuar funksionet, kemi shtuar shërbimet, padyshim që këto shërbime dhe këto funksione bëhen me njerëz, nuk bëhen në ajër. Dhe në qoftë se ne i referohemi 2015-s, sigurisht që kemi shtuar shërbimet, kemi shtuar dhe njerëzit, dhe unë nuk flas për ato shërbime të cilat ne nuk kemi mundësi dhe burime njerëzore për t'i kryer, por flas për ato shërbime që kemi mundësi t'i japim. Për shembull, po ju marr një rast: në qoftë se ne në 2015-ën na u transferua shërbimi i ujitjes dhe kullimit, po kjo sigurisht që u shtua me ca njerëz që i mori bashkia në punë. Sepse ky shërbim nuk mund të jepet gjatë gjithë vitit në qoftë se ti s'ke njerëzit e duhur. Po këta njerëz punojnë me paga. Dhe padyshim që ky është një shërbim që do shtohet edhe në numër, edhe në pagesë, dhe padyshim që ka përqindjen e vet në atë totalin që zë në gjithë pjesën e buxhetit të bashkisë. E njëjta gjë për të gjithë shërbimet e tjera. Në qoftë se ne flasim që kemi marrë shërbimin parashkollor, kopshtet dhe çerdhet, po padyshim që këto shtohen me njerëz, është janë shtuar edukatorët, është shtuar shërbimi i zjarrfikësit, dhe këtu ka njerëz që japin këtë shërbim. Dhe nuk mund të thuash që sot ky shërbim ka këtë pjesë përqindje, këtë përqindje në buxhetin total të bashkisë dhe të mos përmendësh numrin e shërbimeve të shtuara, llojin e shërbimeve të shtuara, padyshim dhe atyre të deleguarve.

#### **Luçiano Boçi:**

Zonja Bufi, funksioni të vjen me paketën financiare të inkluduar brenda dhe nuk mund të rritet në vlerë përqindje kaq sa është rritur nga 36 në 47%. Sepse kjo është rritja fiktive për të cilën unë do thoja dhe është ajo nga këto menaxhimet e shpenzimeve administrative me qëllim që të përfitoshit investime. A keni arritur të përfitoni investime duke kursyer paga nga shpenzime të tilla, domethënë shpenzime, se paga në qoftë se janë paga domosdoshme mirë, por ju kur i shtoni kështu i dyfishoni.

#### **Majlinda Bufi:**

Zoti Boçi, në qoftë se... A keni përfituar dhe i keni kaluar në zërat e investimeve, apo jo? Referoheni bashkisë që ju drejtohet? Gjithë bashkive? Patjetër që po, kjo është e sigurt. Kjo është shumë e sigurt.

#### **Luçiano Boçi:**

Jo, dakord, zonja Bufi, ka një gjë mirë, shumë mirë, se ju e kishit standardin e shërbimit, ia keni kaluar dhe Tiranës, se edhe Tirana ka probleme me zallpastruesit.

#### **Majlinda Bufi:**

Mund të ftoj një ditë të vish në Roskovec, më fal, meqenëse e vë në dyshim, mund të ftoj të vish një ditë në Roskovec me gjithë grupin tuaj. Jo, ka një gjë, edhe ta shikoni, më fal, të lutem, se çfarë ndodhi në Roskovec në lidhje me këto shërbime.

#### **Luçiano Boçi:**

Po të lutem, se ke tendencën edhe një herë tjetër, se s'dua, domethënë se është problemi i respektimit të gruas dhe nuk e ngre shumë.

**Majlinda Bufi:**

Jo, s'ka lidhje me faktin që jam grua.

**Luçiano Boçi:**

Po nuk dua, jo, po nuk dua të ndërhysh pa rregull, se jemi në komision parlamentar dhe një herë tjetër, dhe për drejtë jam dhe pak drejtues i komisionit, prandaj dua më dëgjosh. Nuk kam asnjë lloj kundërshtimi për këtë, sepse madje unë ju mirëpres në ato deklaratimet tuaja ku nxirrni pa që bashkitë e vogla performojnë mirë, sepse po pra prit, prit, po prire mos ndërhyj në konkludim, a je bashki e vogël? A ke standard shërbimi njëlloj si në qendër? Performon mirë? A ke funksionalitet? Paske? A ke financa të shëndoshë që i merr nga të ardhurat e tua? Paske? Domethënë, performon mirë si bashki e vogël? Ke probleme me ca kompetenca inxhinier ndërtimi me planifikim urban që parashtruat dhe një zgjidhje me kompetencë qarku për të cilën thashë që jemi në dakordësi dhe mua kjo më pëlqen, sepse kjo bie ndesh me pretendimet e krahut të maxhorancës, e cila pretendon që sa më e vogël bashkia, aq më jo performante është dhe logjika është sa më e madhe bashkia, aq më e mirë është. Ne këtë logjikë duam që të përmbysim dhe për këtë ju na vini në ndihmë, të them të drejtën, jo se është e vërteta kjo, është e vërteta, pse? Sepse bashkia e vogël ka mundësi që të shpërndahet, ju jeni bashki e vogël, të shpërndahet më mirë, ta kontrollojë më mirë territorin, se sot nuk na e thon, po një nga problemet kryesore që ka planifikimi urban është menaxhimi i ndërtimeve paleje. Nuk e kontrollon dot malakastra në gjithë territorin e madh që ka, ka ndërtime paleje sa të duash, ikën IKMT-ja, ikën policia bashkiake, kudo ndeshen, tolerohen prag zgjedhjesh, meqenëse i trajtojnë njësoj njerëzit prag zgjedhjesh, se e dimë, i kemi bërë vetë këto gjëra dhe tregon qartazi që bashkia menaxhohet mirë kur është e mesme. Përkundër kësaj, krahu këtu do që Roskovezi mos jetë bashki më vete, ta themi si simbol, se mund të jenë bashki tjera. Roskovezi ndoshta ka mbështetje të fortë politike dhe e kalon klasën në këtë projektin e ngritjes së bashkive të mëdhaja. Pra, nuk ju keqkuptoj kjo pikë, por do desha edhe përgjigjen e zotërive, ndërkohë që në fakt e marr nga ekspertët se thatë që Divjaka s'ka pyje, buxheti i bashkisë ka një referencë që ka 1275 hektarë, mos gaboj, apo më pak, domethënë se...

**Josif Gorrea:**

Po, faleminderit, bashkëkryetar, nuk e di nga e keni marrë atë informacion, patjetër kemi 670 hektarë, 700 hektarë pyje kodër të bashkisë dhe kemi një trup punonjësish në lidhje me këtë. Kemi inxhinierë pyes, kemi punonjës pyes dhe nuk di nga e keni marrë këtë, faleminderit, po është e keni komplet gabim në lidhje me këtë element. Dhe jo vetëm aq, jo vetëm aq, por kemi filluar t'i mbanë shtrojnë pyjet. Dhe kemi filluar të nxjerrim dhe të ardhura nga pyjet. Pra, bashkia në rrallim e sipër këto dru që përfitojmë nga rrallimi i kemi vënë në dispozicion qytetarëve kundrejt një pagese normale. Edhe duke ndihmuar që restorantet e zonës ku përdorin dru, përdorin një dru më cilësor lisi që e kemi në këtë

kodrinë të bukur. Kështu që jeni total, për fat të keq, gabim në informacion. Kjo ishte në lidhje me pjesët e tjera të pyetjeve tuaja. Bashkia. Dhe numri i punonjësve dhe kompetencat dhe funksionet. Ka një, ka një, ka një të vërtetë që nëse bie dakord 2014-2015 me 2025 janë 2, janë 10 vite dhe në këto 10 vite. Patjetër që numri i funksioneve është shtuar. Unë vetëm këtë vitin e fundit kemi shtuar 2 funksione të reja në bashki që patjetër kanë marrë një numër punonjësish. Dhe vitin këtë vit gjithashtu kemi shtuar dhe disa të tjerë, kështu që e thënë shkurt, patjetër që numri i punonjësve justifikon funksionet që neve ofrojmë në bashki. Kishte një pyetje tjetër në lidhje me shërbimin që merr qytetari, po mundohem ta shpjegoj në rastin tim. Çdo qytetar ka 2 mundësi në rastin e bashkisë Divjak. Ai e merr atë në njësi. Por kush ka dëshirë vjen e merr edhe në qendër, ose shumë herë ato kombinohen. Kështu që patjetër që shërbimet bazë të nevojshme qytetari i merr pranë qendrës ku ai banon, pra në ish-njësinë e tij. Por i është shtuar edhe mundësia tjetër që mund të vijë edhe në qendër për ta marrë shërbimin më të më të shpejtë, ndoshta. Faleminderit, nëse kolegët kanë tjetër, le të shtojnë.

### **Luçiano Boçi:**

Po, tjetër, okej.

### **Qerim Ismailaj:**

E nderuar bashkëkryetar, lidhur me efizienzën administrative që ka qenë qëllimi i reformës së 2014-s. Unë besoj që efizienzën administrative lidhet me efizienzën e kryerjes së shërbimeve dhe funksioneve të cilat janë ngarkuar bashkive. Këtu referohet një përqindje e caktuar, e marrë 47, ka shkuar 47 nga 36. Besoj e shpjegova rastin e bashkisë Malakastër përpara, por ajo çfarë përtej shtimit të funksioneve. Por kemi edhe një shtim të hapësirës së shërbimeve dhe shtimi i hapësirës së shërbimeve dhe llojit të shërbimeve që ofron bashkia. Natyrisht e tha dhe kolegja, tha dhe kolegu, kërkon patjetër që të ketë një numër të caktuar punonjësish apo specialistësh dhe unë besoj që nuk ka rritje të numrit të administratave, por ka rritje të numrit të punonjësve që lidhen me shërbimin. Kjo pikë së pari dhe këtë përqindje tjetër e dimë shumë mirë, është një element shumë i rëndësishëm në buxhetin e bashkive. Funksionet e deleguara të transferuara, të cilat paguhen nga nga bashkia. Pjesë e kësaj është edhe shërbimi i gjendjes civile, pjesë e kësaj është edhe shërbimi i zjarrfikëseve, edhe shërbimi i pyjeve dhe i kullimit. Pra, janë një sërë shërbimesh të cilët paguhen me fondet deleguara dhe automatikisht, duke futur brenda buxhetit të bashkisë, këto e rrisin përqindjen, sepse në qoftë se është formulë shumë e thjeshtë, në qoftë se ke 100 lekë buxheti dhe të vijë edhe 20 lekë të tjera vetëm për paga për këto funksione, natyrisht që nëse përpara harxhohej 30 lekë për paga, tani do harxhosh 50 nga 120 dhe kjo patjetër që e rrit përqindjen, këtë përqindje që që u diskutua pak më parë dhe a kemi standarde minimale. Natyrisht që të ofrosh shërbime, unë besoj që një bashki e madhe ka standarde më të mëdha dhe më cilësore ofrimi i shërbimit ndaj qytetarëve sesa një bashki e cila nuk do të ketë as mjetet logjistike, as staf të mjaftueshëm për të kryer shërbimet bazë. Natyrisht këtu ka probleme dhe ne ngritëm disa problematika, siç ishte qartësimi i disa kompetencave dhe përmirësimi në legjislacion i disa funksioneve dhe kompetencave përkatëse. Natyrisht që çështja e financimit ka

nevojë gjithmonë e më tepër. Askush nuk pretendon që financat janë të mjaftueshme në asnjë institucion shtetëror, qoftë ky vendor apo qendror. Natyrisht ka nevojë gjithmonë e më tepër në funksion të kjo gjithmonë në funksion të kryerjes së investimeve kapitale, por unë besoj që u përqendrua, pra aq sa më lejohet, gjithë vëmendja u diskutua si po flasin kryetarët e bashkisë në favor të opozitës apo në favor të pozitës. Por unë mendoj që ky komision dhe ne të gjithë bashkë në këto djese duhet t'i bëjmë që të kemi një reformë administrative të suksesshme në funksion të shërbimit qytetar.

**Luçiano Boçi:**

Këtë e kemi përcaktuar që në fillim, zoti Ismailaj, dhe madje në këtë kontekst i kemi bërë të gjitha pyetjet, pavarësisht parashtrimeve tuaja për të cilat kemi tërhequr vazhdimisht vëmendje, se s'jemi për performancën, po jemi për shërbimin ndaj qytetarit. Prandaj po ndërmerret kjo reformë. Ky është fokusi jonë. Je shumë i qetë këtu. Prandaj dhe është ky komunikim. Po atëherë, në qoftë se s'ka të tjerë...

**Eriselda Sefa:**

Mund të lë? Mund të...

**Arbjan Mazniku:**

Atëherë, zonja Stefa, po të lutem.

**Eriselda Sefa:**

Atëherë, për sa i përket pyetjeve të zotit Boçi, do të thoja që vërtetë reforma territoriale si u bë në 2014-n kishte një numër të kufizuar në administratë, por mos të harrojmë që në këto 10 vite ka pasur shumë funksione që janë shtuar institucioneve të bashkive, çka ka bërë që ne për t'i përmirësuar këto shërbime patjetër që na lind sidomos dëshmëri të shtojmë edhe stafet tona. Po marr një shembull: në 2016-n bashkive i është shtuar shërbimi i zjarrfikës. Për numrin e popullsisë që unë kam, unë në institucionin e bashkisë u transferuan vetëm 14 punonjës të shërbimit të zjarrfikës, ndërkohë që në ligj duhet të ketë 65 punonjës të shërbimit të zjarrfikës. Patjetër që ne nuk e kemi arritur këtë numër, e kemi më të ulët se 65, por kjo do të thotë që ne e kemi rritur atë numër sepse duhet t'i shërbejmë qytetarëve tanë dhe ndërkohë që kur na jepet ky funksion ose grant nga qeveria, na jepet vetëm për 14 punonjës që paguhen nga ky funksion, ndërkohë që me të ardhurat e bashkisë unë duhet të paguaj pjesën tjetër të stafit që kam shtuar, por patjetër dhe përmirësimin e infrastrukturës, në mënyrë që ky shërbim të shkojë atje si duhet tek qytetarët tanë. Patjetër që shërbimi social, në momentin që ka ndodhur reforma, punonjësit socialë ishin vetëm për ndihmën ekonomike dhe për pensionin e invaliditetit. Sot janë shtuar një sërë shërbimesh sociale për bashkitë, po marr konkretisht bashkinë e Lushnjes. Sot ka një qendër për trajtimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar, të cilët çdo ditë atje është një staf i cili i shërben atyre fëmijëve. Ka një qendër për moshën e tretë, ka një qendër rinore, ka një qendër që i shërben për komunitetin rom dhe egjiptian. Çfarë duhet t'i bëjmë këto qendra sociale? Ne nuk duhet t'i shtojmë staf që t'i shërbejmë qytetarëve tanë. Kjo bën që ne, veç funksioneve të cilat na janë deleguar në bazë të shërbimeve që

duhet t'i ofrojmë qytetarëve, patjetër që na është dashur të bëjmë edhe një shtesë stafi. Që kemi nevojë për financa, askush nga kryetarët e bashkive nuk do të thoshte jo. Patjetër që kemi nevojë. Vazhdoj t'i mëshoj fjalës që ne kemi nevojë të jemi më të decentralizuar si nga ana funksionale, por patjetër edhe nga ana ekonomike, dhe vazhdoj t'i mëshoj edhe faktit që prandaj e përmenda në fillim që kam qenë punonjëse administrate e një bashkie të vogël dhe sot drejtoj një bashki të madhe. Një bashki sa më e madhe të jetë, ka avantazhin që ka fuqi ekonomike më të madhe për t'i shërbyer më mirë qytetarëve dhe për të kryer sa më shumë investime, por patjetër ka dhe kapacitete stafesh më të mira që normalisht këto shërbime të shkojnë, të përmirësohen.

### **Luçiano Boçi:**

Çështja e kapaciteteve dhe e performancës së një bashkie të madhe dhe të vogël është çështje e vlerësimeve që u dhanë nga ju, jo thjesht nga pyetjet tona. Ne donim ta nxirrim nëpërmjet pyetjeve dhe morëm të tilla përgjigje. Nga ana juaj që bashkitë e vogla e të mesme performojnë, e kanë shkallën e performancës më të mirë se bashkitë e mëdha, realisht edhe financiare, edhe në aspektin e shërbimeve se e kanë standardizuar. Kështu u tha, domethënë, jo se po e pohoj unë, e kanë të njëjtësinë qendër ashtu edhe në periferi, ndërkohë që në Lushnje nuk besoj se është e njëjta si në Lushnje, në Lushnje, edhe diku larg në një periferi të Lushnjes. Megjithatë, vetëm një gjë e vogël për ta mbyllur, sepse pata një replikë me zotin Gorea, tha që ku e gjete një punonjës? Në fakt, ja nisëm nga një shkresë e institucionit tuaj që është projektvendim dhe përcakton numrin e punonjësve sipas sektorëve. Dhe në administratën, në qendrën e bashkisë, thotë projektvendimi, ta jap dhe datën, po deshe, 17.12.2015. Është po 2015, po. E 25. Po, po, po. Edhe 139 punonjës qendra e bashkisë komunale, po 2025-n komunale ke 115. Pastaj me radhë Tërbufi, Gradishta, Grabjani përcakton dhe sektori i pyjeve këtu një punonjës më rezulton. Dhe po pra 25-s, 25-s, se e lexova unë gabim, 25-s, jo, e lexova nga kjo shkresë, nuk është se jam dhe deputet i qarkut në këtë rast, por u habita. Nga ajo që s'ka pyje ndivjak më shumë kur na e thanë apo e thanë të tjerët, nuk e thatë ju, e thanë kolegët tuaj.

### **Arbjan Mazniku:**

Për ta, për të përmbyllur dy-tre, dy-tre. Që ishte afër 5. Dy fjalë të shkurtra për ta mbyllur sipas meje. E pari është një argument i cili kthehet në mënyrë sistematike dhe besoj që vlen që për publikun që na ndjek, po dhe për kryetarët, të qartësojmë një element që ndoshta nga jo nga kushdo kuptohet. Bashkitë kanë dy struktura stafesh, kanë stafe që janë aparati, që janë njerëzit të cilët merren me administrimin. Nënpunësit civilë tipikisht, të cilët kanë detyra, financën, zyrën juridike, planifikimin, planifikimin urban, funksionet planifikuese që punojnë pranë kryetarit të bashkisë. Kanë dhe stafet e shërbimeve, njerëz që merren drejtpërdrejt me ofrimin e shërbimit. Reforma e 2014-s ka ulur në mënyrë të qëndrueshme stafet administrative. Po u jap dy-tre shembuj, punonjësit e bashkisë tjerë, aparati ka pasur 770, ka sot 314. 56% më pak. Bashkia Lushnje ka pasur 315 ose njësitë që u bashkuan në bashkinë Lushnje, sot kanë 199 ose 36% më pak. Bashkia Malakastër ose bashkitë që u bashkuan në bashkinë Malakastër pas 334 kanë 106. 68% më pak. Bashkia Patros ka qenë 146, janë 57, 61% më pak. Bashkia Roskovec kanë qenë 210,

janë 76, 63% më pak. Pra, aparatet në tërësi janë ulur në mënyrë të qëndrueshme. Nga ana tjerë, kur ne flasim për struktura të reja, mirëmbajtja e shkollave, punonjësit e çerdhe-kopshteve, kanalet kulluese-vaditëse, zjarrfikëset, pyjet dhe livadhet, padyshim që për t'i ofruar këto shërbime, bashkitë kanë shkuar, kanë shtuar stafin. Nga ana tjerë, një numër i cili është dy numrat e fundit që janë të rëndësishëm të themi, është që në totalin e buxhetit të bashkive dhe komunave të vitit 2014, 70% e shpenzimeve shkonin për paga dhe sigurime. Sot shkojnë 42%, që do të thotë në tërësinë ndryshimet të gjitha kanë shkuar në raport për shpenzimet operative, që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen, ndriçimin dhe shpenzimet tjera operative dhe investimet, padyshim. Dhe numri i fundit është. Kemi folur në mënyrë sistematike këtu për numrin mesatar të popullsisë së bashkive. Ky është një numër i cili nuk na tregon një vërtetë reale. Numri i vërtetë na e tregon mediana, jo mesatarja, sepse kur fusim Tiranën brenda me 600 mijë banorë dhe një qytet tjetër me 20 mijë, mesatarja lëviz shumë, se i bie që mesatarja mes të dyve është 300 mijë. Mediana e bashkive në Shqipëri është 19 mijë e 261 dhe nisur nga ky numër, Roskovec-i nuk hyn te bashkitë e vogla. Ka 16 mijë e 332 banorë dhe nuk hyn te bashkitë e vogla nga pikëvështrimi i medianës, të paktën, po flas këtu vetëm nga një pikëvështrim statistikor. Kështu që kjo është thjesht për diskutim, për ta vendosur peshën siç duhet. Këto janë komentet e fundit që kam dhe nëse bie dakord.

#### **Luçiano Boçi:**

Po, unë iu referova zonjës Bufi kur tha që bashkia Roskovec është bashkia më e vogël e qarkut Fier. Po, dhe dhe Balafaqimi, po pra, dhe Balafaqimi ishte brenda qarkut Fier. Unë nuk e çova përtej qarkut Fier, e Balafaqova për performancën dhe pyetjet e mia brenda qarkut Fier dhe isha shumë në rregull. Ndërsa çështja e rritjes së shpenzimeve për pagat, thashë dhe njëherë tjetër, ishte e parashikuar me atashimin e funksioneve dhe në bazë të kësaj lidhje u pretendua që do uleshin shpenzimet për paga, për administratën dhe do shtoheshin investimet. Tani, kjo ishte reforma, ky ishte qëllimi i reformës dhe në fakt për këtë jemi këtu në terma shumë të thjeshtë që e arriti këtë qëllim? Jo, nuk e arriti, dështoi se u dyfishua numri i punonjësve në rang kombëtar dhe këto lekë harxhohen për paga, për aparat, jo aparat, do të thotë që ka njerëz që fusin kartën në aparat, po marrin lekë ato në aparat nga ai aparat. Kështu që kjo shpjegon edhe pjesën e rritjes, ndërsa edhe njëherë tjetër për divjakën është vendimi juaj, ndërsa viti 2015 është referenca ligjore e 17.12.2015. Vendimi juaj është 16.12.2015, kryetar, një punonjës për pyjet ke, një është shkresa juaj, po deshe jua dërgoj unë, e kam këtu. Ja ku është shkresa, meqenëse e do shkresën edhe e ke të nënvizuar pyjet me rozë, madje me ngjyrën që e dallon 1000 kilometra larg. Ja pra, dakord se s'është shkresa ime, është projektvendimi juaj. Faleminderit, faleminderit se je pa mikrofon. Po mirë pra, ja këtu jam nisur unë tashi, ti mund t'i kesh rezervë ato, unë lexoj shkresat. Në qoftë se ju ecni pa shkresa, është çështja juaj pastaj, ose shkruani ndryshe, realizoni gjëra tjera, veproni ndryshe. Faleminderit.

#### **Arbjan Mazniku:**

Atëherë ju faleminderit shumë, bëjmë një 5-minutësh pushim para se të fillojmë me Shkodrën.

